

INTERVISTË ME XHAFER NULIN

Mitrovicë | Data: 21 tetor, 2020

Kohëzgjatja: 107 minuta

Të pranishëm:

1. Xhafer Nuli (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotri Xhafer, nëse mundeni një prezantim edhe me na tregu diçka për familjen e juaj, prejardhjen?

Xhafer Nuli: Unë quhem Xhafer Nuli, i lindun me 06. 02. '47 në fshatin Zasellë në familjen Nuli. Paraardhësit e mi gjegjësisht kanë qenë, gjithëherë jonë marrë, kryesisht me bujqësi. Kanë jetu aty në fshat osht' ekskluzivisht i... si me thonë jemi farefis, nuk ka t'përzimë. Shkollën fillore e kom kry në Zasellë në fshat. Jo plotësisht, vetëm klasën e parë edhe t'dytë, kurse klasën e tretë dhe të katërt e kom kry në Tunelin e Parë që osht' pesë kilometra prej aty. Kom udhëtu, domethonë osht' dashtë gjithëherë osht' dashtë me udhëtu si fëmijë në klasën e tretë.

Anita Susuri: Pse, a s'ka pasë klasë tjera, a shkollë?

Xhafer Nuli: Nuk ka pasë klasë ma shumë. Ajo deri në të dytën klasë e ma shumë është mbyll se s'ka pasë ma shumë, osht' dashtë me shku në Tunel të Parë. Nën kushte shumë të fshtira të atëherëshit, natyrisht mue deri në vitin '57 m'ka vdek baba, kom mbet si fëmijë dhjetë vjeçar, por mirëpo jemi rrit në një familje të gjonë me mixhallarë e të tjerë që kemi qenë familje e bashkësisë familjare. Deri atëherë, deri sa ka vdek baba ka punu në "Trepçë" dymbëdhjetë vite, prej '45-tës deri në '57-tën. Mandej me një pension kemi jetue krejt familja dikun 17 anëtarë, me një pension që e kemi marrë të babës që ka punu aty.

Anita Susuri: E baba në "Trepçë" a i ka ndodh aksident?

Xhafer Nuli: Jo, baba ka vdek prej vdekjes natyrale ashtu që stërgjyshi im Isufi ka qenë, kom pasë mundësinë me fol edhe ni... ksi fotografi. Stërgjyshi im ka qenë Isufi, ka qenë kryeplak i fshatit. Osht'

një plak i nderuar, një plak si me thonë i avancum. Në fshatin tonë në vitin 1932 osht' hap një mejtep¹ si...

Anita Susuri: Shkollë...

Xhafer Nuli: Fetare, si shkollë fetare. Në atë mejtep ka mësu baba im, osht' baba im dhe aty atë kontributin kryesor për hapjen e atij mejtepi e ka dhonë stërgjyshi im Isufi që është edhe aty në plan të parë si figura ma markante, thjeshtë në plan të parë si kryeplak i fshatit. Ka qenë një figurë shumë e respektuar jo vetmë në fshat, por në të gjithë regjionin. Ashtu që, mas vdekjes të babës, masi e kom kry klasën e katërt fillore më osht' dashtë për shkak të kushteve me ndërpre shkollimin për dy vite. E kom ndërpre shkollimin. Mandej kom vazhdue, mas dy viteve kom vazhdu në klasën e pestë gjithashtu në Tunel të Parë edhe e kom kry deri në klasën e tetë. Shkollën e mesme e kom kry gjimnazin në Mitrovicë, mandej kom studiue, kom fillu studimet në vitin 1968 kom fillue në Prishtinë Fakultetin e Elektroteknikës dhe e kom marue fakultetin në vitin 1973.

Anita Susuri: Deshta diçka me ju pytë...

Xhafer Nuli: Fakulteti ka qenë pesë vjeçar.

Anita Susuri: Para se me kalu te ajo pjesa e ma e fakultetit, deshta me ju pytë edhe pak për shkollë. Qysh ka qenë për juve si fëmijë me udhëtu gjithë atë...? A ka pasë naj organizim a veç në kamë keni shku? Qysh?

Xhafer Nuli: Jo veç në kamë kemi shku. Jo në kamë kemi shku, s'ka pasë organizim atëherë.

Anita Susuri: A u konë fshtirë?

Xhafer Peci: Rruga shumë të rona, rruga shumë të fshtira kanë qenë. Atëherë ka pasë dimra shumë të ronë që ka qenë borë shumë e madhe. Unë edhe kështu ashtu kom qenë mjaft i vogël me trup që menxi shkojshim, menxi e qitsha kryt prej borës t'u shku nëpër borë, por e kom pasë një mixhë që ka qenë nja tri vjet para meje. Ai ka pasë metë me mësim, me shkollë me mu bashkë. Ai ka qenë bajagi i rritshëm. Ai ma çelke rend, unë përmas tij shkojsha qashtu si lepur (buzëqesh).

Anita Susuri: A ka pasë edhe fëmijë tjerë, a veç ju kur keni shku prej fshatit?

Xhafer Peci: Ka pasë edhe fëmijë tjerë po po. Kemi qenë krejt fëmijët e fshatit kryesisht kemi shku në Tunel të Parë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë atëherë ajo shkollë?

¹ *Mejtep, Maktab* (përkthimet arabe përfshijnë *makteb, mekteb, mektep, meqteb, meqtab*), i quajtur gjithashtu një Kuttab ose shkollë, është një shkollë fillore. Megjithëse u përdor kryesisht për të mësuar fëmijët se si të lexojnë, shkruajnë, gramatikë dhe studime Islame si Kira'at (recitim Kur'anor), lëndë të tjera praktike dhe teorie gjithashtu shpesh mësoheshin.

Xhafer Nuli: Urno?

Anita Susuri: Shkolla ka qenë tetë vjeçare aty apo...?

Xhafer Nuli: Ka qenë, atëherë për fillim nuk ka qenë tetë-vjeçare, ka qenë katër-klasëshe. Mandej në klasën e pestë kur kom dalë, kur kom dalë unë në klasën e pestë, domethonë mas dy viteve atëherë osht' hap klasa, osht' hap tetë-vjeçarja në Tunel të Parë se s'ka pasë tetë-vjeçare as në Tunel të Parë, veç katër-vjeçarja. Atëherë kemi shku domethonë deri të tetën edhe mandej kemi kalu aty.

Anita Susuri: Ju thatë që e keni hup babën si shumë i ri?

Xhafer Nuli: Po.

Anita Susuri: Sa fëmijë jeni familja? A jeni ma i vogli?

Xhafer Nuli: Na t'babës e t'nanës që jemi kemi qenë gjashtë fëmijë. Dy vllazën e katër motra. Vëllau ka qenë para meje ma i vjetri, tri vjet para meje e edhe ai e ka kry fakultetin, në t'vërtetë e ka kry ma parë Shkollën e Lartë Fizikë, Kimi, mandej e ka kry Fakultetin e Ekonomisë. Ai tash për tash osht' në Gjermani me familje prej vitit 1993.

Korab Krasniqi: E motrat?

Xhafer Nuli: Motrat jonë të... njena është në Amerikë te djali i vet, aty djalin e ka, njena, dy jonë këtu në Mitrovicë edhe një osht' në Prishtinë.

Korab Krasniqi: A kanë kry motrat shkollë?

Xhafer Nuli: Motrat nuk kanë kry shkollë, jo. Me të thonë të drejtën atëherë pak ka pasë mundësi për femra, s'ka qenë naj vend, mirëpo edhe me pasë menxi që kemi arrit me u shkollu na (qesh). Pak osht' egoizëm, por qashtu kanë qenë edhe kushtet edhe rrethanat. Pa u shkollu mashkulli femra s'ka mujt m'u shkollue. Kështu që na kemi qenë ma të mdhej jemi shkollu na, femrat, vetëm një motër e ka krye, njena prej motrave e ka kry Shkollën e Mesme të Medicinës.

Korab Krasniqi: E dy vite pse e ki ndërpre?

Xhafer Nuli: Urno? {afrohet me trup}

Korab Krasniqi: Dy vite në klasën e katërt?

Xhafer Nuli: Për shkak të kushteve osht' dashtë mu përkujdes për bagëti, me i rujt dhentë, me i rujt dhentë. (buzëqesh)

Anita Susuri: Ju thatë që baba juj ka punu në “Trepçë”.

Xhafer Nuli: Po.

Anita Susuri: Ju s’e mbani në mend babën e juj, por a e dini që...

Xhafer Nuli: Jo, unë e mbaj mend babën tem mirëpo jo shumë kështu.

Anita Susuri: A e dini diçka për shembull kur u kthy ai prej punës qysh osht’ dokë? Se zakonisht puna ka qenë e rondë, a e mban mend?

Xhafer Nuli: Puna ka qenë shumë e rondë. Ai nuk ka punu konkretisht drejtpërsëdrejti në minierë si xehëtar, por ka punu si gyptar. Pak pune ma e lehtë, megjithëse në minierë ka qenë. Osht’ dokë, ndoshta kurgjo tjetër s’kom majt n’mend, por e maj n’mend rrobet kur i ka pru mi la, rrobet e punës qysh ja nijshim erën ku me ditë ku atyne rrobeve, era i vjen, era xehe i vjen si barut prej atij piritit. Atëherë e maj n’mend ato. Ka qenë punë mjaft e fshtirë.

Me të thonë të drejtën në ato kohë përpos që... por e di edhe një diçka, që ai që ka punu në “Trepçë” për shembull, punëtori që ka punu në “Trepçë”, familja osht’ dashtë me pasë një kujdes të veçantë ndaj tij edhe me e rujt edhe si me thonë m’u kujdes për to. Unë e di që në ndrim të tretë kur ka qenë për shembull kur ka ardhë në shpi ka flejt gjatë ditës osht’ dashtë gjelat prej oborrit m’i largu mos me këndu me ja nxerr gjumin.

Anita Susuri: A është e vërtetë që e kanë pasë një ushqim si ma t’veçantë?

Xhafer Nuli: N’familje po, po ushqimin e veçantë e ka pasë, ushqimin e veçantë e ka pasë gjithëhere.

Anita Susuri: Për shembull, m’duket që ma shumë qumësht duhet me pi.

Xhafer Nuli: Qumësht ka pi ai ma tepër. Me të thonë të drejtën ai edhe vet kështu apetitin s’e ka pasë, mish fort nuk ka konsumu, mirëpo qumësht vazhdimisht.

Anita Susuri: Çka mbani tjetër në mend prej qasaj periudhës domethonë të shkollës së mesme kur keni fillu? Qysh keni fillu? Çfarë vështirësi ka pasë?

Xhafer Nuli: Në shkollë të mesme, në shkollë të mesme veç në ‘64-tën kur kom fillue ka qenë pak një, ka qenë pak ma si me thonë...

Anita Susuri: Situata ma e mirë?

Xhafer Nuli: Një situatë pak ma e mirë, megjithëse situata e mirë deri mas '66-tës nuk ka qenë. Tek mas '66-tës me rrxumjen e Rankoviçit [Aleksandar Ranković]² atëherë osht' kriju pak njëfarë lehtësie me marrë frymë pak ma shirë populli edhe njerëzia. Mirëpo, kur kom fillu unë në shkollë të mesme për shembull unë tri landë i kom pasë në gjuhën serbo-kroate, tri-katër landë. Mu më osht' dashtë përmendsh me msue ato mësimë se s'e kom ditë gjuhën absolutisht s'e kom ditë gjuhën edhe u dashtë me mësu përmendsh. Unë e maj n'mend për shembull kur një profesor i gjuhës serbo-kroate u konë njëfarë Raspopoviçi.

I kisha t'gjitha notat me kalu shkëlqyeshëm, ai ma la një dysh në serbisht për arsye se m'çoi me fol, unë n'qat moment m'nxoni gafil nuk dita qaq mirë edhe tha, "Ti po mson në mënyrë kampanje", me thonë që, "Po, vallahi veç përmësh jom t'u msue" (qesh) dhe mandej kërkova me çdo kusht me m'pyt edhe një herë. Tek ma vonë dikur ma përmirësoi notën, e boni një tresh sa me mujt me kalu shkëlqyeshëm.

Anita Susuri: E përmendët qatë kohën e Rankoviçit. Po më intereson a ju kujtohet, se shumë shqiptarë janë largu në atë kohë, jonë domethonë përzonë me një fjalë...

Xhafer Nuli: Mu m'kujtohet si fëmijë, m'kujtohet kur ka qenë aksioni i mbledhjes t'pushkëve. Në fshat tonë e di që u përmendke, u përmendke thojshshin. Si fëmijë çka thojshin që dëgjojshim, "Filanin e kanë detyru me nejt gjithë natën me komë n'borë dathun. Filanin e kanë detyru qeshtu, filanin e kanë detyru qeshtu" edhe plus asaj i kanë kërkue me na qit dy pula një gjyveq, tridhjetë vo një përpeq (qesh) e ku ta di unë edhe thotë, "Petllat për mëngjes, petlla me i qit me mjaltë, ku s'ka mjaltë me i qit sheqer" edhe ku u kthy me hangër thotë, "O Sharr *planin* (serbisht - mal) he bir" (qesh).

Anita Susuri: Domethonë, kanë lyp me ju plotësu do kushte?

Xhafer Nuli: Ndoshta detajet nuk i meritojnë këtu m'u cekë mirëpo qeshtu.

Anita Susuri: Po më intereson familjes t'juj a ju kanë ndodh qato?

Xhafer Nuli: Familjes tonë nuk i kanë ndodhë ato, nuk kanë ndodhë në familjen tonë, kërkon nuk e kanë torturue ashtu. I kanë marrë, i kanë pyet, me gjetë një pushkë. Nuk kemi pasë pushkë, mirëpo s'të ka vetë ai, çdokujt i ka lyp pushkë.

Anita Susuri: Po, se e di që njerëzit edhe kanë shku me gjetë dikun pushkë me ia dhonë njo se i kanë torturu.

Xhafer Nuli: Qashtu, qashtu bash qashtu.

Anita Susuri: Tash domethonë shkollën e mesme thatë që e keni vazhdu...

² Aleksandar Ranković (1909-1983) ishte një politikan komunist Jugosllav, i konsideruar si njeriu i tretë më i fuqishem në Jugosllavi pas Josip Broz Tito dhe Edvard Kardelj.

Xhafer Nuli: Shkollën e mesme e kom kry këtu në Mitrovicë, e kom fillu në Mitrovicë mandej kom vazhdu deri sa e kom kry shkollën e mesme. Mandej prej shkollës së mesme kom shku në Fakultet në Prishtinë. Në Fakultet kom shku në '68-tën. Në '68-tën kanë qenë demonstratat e '68-tës. Kom qenë pjesëmarrës i domestratave dhe në laborator të fizikës kemi qenë tu i bo ushtrimet kur osht' ardhë koha me dalë në demonstrata edhe pse ma përpara na e kena marr ëni tekst m'i lexu do vargje çka duhet me brohorit e me thonë.

Korab Krasniqi: Për çka osht' protestu?

Xhafer Nuli: Urno?

Korab Krasniqi: Për çka osht' protestu?

Xhafer Nuli: Atëherë osht' kërkue, "Kushtetutë, Republikë, Flamuri".

Anita Susuri: Domethonë, para se me fillu demonstratat jonë kanë do përgaditje që bohen?

Xhafer Nuli: Po, po, po gjithsesi.

Anita Susuri: A i keni njoft ata njerëz që ju kanë pru ato parulla?

Xhafer Nuli: Do i kom njoftë une si i ri.

Anita Susuri: Si kolegë.

Xhafer Nuli: S'i kom njoft ku me ditë çka, mirëpo e kom njoft nifarë Sylë Pepozhi i thojshin. Ai ku osht' tash nuk e di. Ai te na n'konvikt na i ka pru ato me i lexu, me i kqyr, me i lexu.

Anita Susuri: Edhe qysh u kanë kur keni dalë atë ditë?

Xhafer Nuli: Atë ditë...

Anita Susuri: A ka pasë polici?

Xhafer Nuli: Atë ditë kur kemi dalë, kemi dalë prej t'gjitha anëve ka vërshue në ora katër masdite, ka vërshu prej t'gjitha anëve. Një grup, grupi kryesor ka fillu prej Fakultetit Filozofik që i thojmë na, Filologjik aty ku osht' edhe sot Fakultetet. Mandej na jemi taku tash ku osht' ndërtesa e Universitetit. Na kemi dalë prej nalt kemi qenë Fakulteti i Elektroteknikës, ka qenë nalt në ato barakat ku osht' Akademia tash, aty kanë qenë ndërtesat edhe jemi lshu te poshtë, jemi bashku me ta.

Para se me mrrri aty kur t'jonë nisë ata ka katër herë revole ka qitë dikush që u nis, parullat i kanë pru meniherë me kerr. Kemi marrë parullat, kemi dalë, kemi brohorit. Kemi shku deri te Këshilli Ekzekutiv te Kuvendi ku osht' Kuvendi aty. Jemi kthy, aty e kemi majt një kohë sa me thonë paraqitje të

individëve sene. Ka pasë ndërhyrje ka kemi shku, ka pasë ndërhyrje të policisë edhe të këtyne zjarrëfiksive me ato ujë me na gju, mirëpo edhe studentat ju kanë përzi, ja kanë demolu ato paisjet e sene. Ka pasë edhe policë që kanë tentu, mirëpo ka pasë tradhëti edhe të disa shqiptarëve e sene, jonë tërhek se e kanë pa...

Anita Susuri: Rrezik.

Xhafer Nuli: Nuk ka pasë dhunë, nuk ka pasë prej neve, prej neve edhe pse na kanë dalë në prit. Herën e dytë mandej kemi shku prapë te Fakulteti. Atje kanë majt fjalë disa. Ka pasë disa që nuk i kanë lonë me fol, ka pasë asi, mirëpo kemi shku për herë të dytë. Për herë të dytë kur kemi dalë, atëherë kanë ardhë një kontigjent i policisë prej Maqedonisë. Ata kanë ndërhy me egërsi të madhe dhe ka fillu njëfarë përlëshje. Kemi dashtë me shku deri te burgu, nuk na kanë lonë. Gjatë kalimit ka sheshi aty prej asaj “Toskanës” tash, atëherë “Avalla” i thojshin, prej aty ka shti me armë një serb thuhet këtu i Vojbulës një qyteze ka shti e ka vra një nxanës, nxanës ka qenë ai që u vra.

Mandej kemi shku prapë deri te Kuvendi atje, jemi kthye edhe ma n’fund dikur ka mesnata ka marrë fund ajo. Të nesërmen kemi dashtë me dalë me shku në Fakultet, nuk na kanë lonë. Kemi qenë totalisht të bllokum në t’gjitha anët edhe nuk kemi mujt mo me shkue, mirëpo ato murrën jehonë. Ka pasë tendencë me bo ato si me thonë, me diferencime ku ta di unë, i kanë diferencu disa që për ne si studentë, unë si brucosh nuk kom pasë naj peshë, mirëpo pjesëmarrës kam qenë aty.

Anita Susuri: A e dini naj profesorë t’juj që e kanë burgosë ose naj kolegë?

Xhafer Nuli: Jo, nuk e di, nuk m’kujtohet asnji profesor. Qatë Sylën e di, qato se në fakultet me neve ka qenë. Qato e kanë marrë, por nuk di mo çka osht’ bo me to se mo n’fakultet ato nuk e kom pa.

Anita Susuri: Nuk e keni pa mo kurrë?

Xhafer Nuli: Nuk e kom pa mo kurrë.

Anita Susuri: Tash deshta pak për jetën e juj, domethonë prej Mitrovicës në Prishtinë me banu.

Xhafer Nuli: Prej Mitrovicës.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë kushtet? Ku keni banu?

Xhafer Nuli: Kryesisht gjithëherë kom banu në konvikte. Në vitin e parë kom banu në këto pavilionet këtu te Fakulteti Ekonomik, kanë qenë do pavilione, do ndërtesa, kazerma të ushtrisë kanë qenë, mandej jonë adaptu për studentë. Në vitet tjera, në vitin e dytë dhe të tretë kom banu në konviktin numër një, qaj që osht’ tash nuk e di sa e ka numrin, numër tre m’doket osht’ tash. Qai i pari osht’ ndërto atëherë i ri. Mendej kom banu edhe në vitin e katër e t’pestë në konviktin numër tre ai n’skej n’fund atje që osht’.

Kom qenë, kom pasë, si me thonë kemi qenë një grup shokësh shumë t'mirë, kom rastin ishalla kurrë nuk i harroj, githëherë i majmë kontaktin me ta. Kemi qenë një grup shokësh me Jusuf Krasniqin, me Ali Hamitin, me Avni Dikën, me Gani Bimbash, jonë një numër shumë mirë që kemi kalu edhe sot e asaj dite i majmë lidhjet, i majmë kontaktet.

Anita Susuri: Tash po më intereson kështu, shumica thojnë që Prishtina nuk u konë shumë si qytet i zhvillim.

Xhafer Nuli: Prishtina ka qenë...

Anita Susuri: Qysh e keni pa ju?

Xhafer Nuli: Po të tregoj që në ato konvikte unë kur kom shku në vitin e parë m'u doke dhoma po m'han ajo dhomë e konviktin. Katër metra e ka pasë tavanin e naltë. Kur u ulsha n'krevet me msue e pajsha tavanin nalt m'u duke që si naj bishë me m'u lshu mbi kry. Mirëpo, mandej në konviktin që kemi shku nalt, në konviktin numër një që po thom, atëherë rruga lloq ka qenë. U punojke, atëherë u punojke ajo rrugë anej. Veç me çizme kemi shku, nuk kemi mujt me shku ndryshe. Si ka fillu me ra shi veç me çizme, ndryshe s'ki mujt, çizme t'gomës.

Anita Susuri: Qyteti çfare u konë?

Xhafer Nuli: Qyteti ka qenë një qytet i thjeshë, qyteti ka qenë mjaftë i vjetër, i pazhvillim, nuk ka pasë najfarë infrastukture, najfarë zhvillimi, najfarë... Absolutisht kushtet kanë qenë atëherë kanë qenë shumë të fshtira.

Anita Susuri: Për shembull, nëse e krahasoni me Mitrovicë?

Xhafer Nuli: Unë që po thom kur kam banue në konvikt për shembull këtu në pavilon, kur shkojsha, m'u dashtë me shkue ka qenë në Shtëpi të Mallrave që osht' aty te "Zahir Pajaziti" ka qenë shtëpia e mallrave, "Gërmia" u thirrke atëherë. Shkojsha te një dajë, ai punojke aty se kishte nxemje qëndrore, shkojsha rrisha për me u nxe se nirthsha në konvikt, nuk kish. (qesh)

Anita Susuri: E a ka pasë kështu që keni dalë dikund a m'u shetitë me shoqni?

Xhafer Nuli: Jo, me shoqni kemi dalë se s'kemi pasë, u dashtë me pasë kushte e sene, nuk kemi dalë. U organizojshin në '71-tën, jonë organizu do Elektriada, ksi gara të studentëve të elektroteknikës prej prej Jugosllavisë. Elektriada osht' organizu në Poreq. Atje kemi qenë krejt si grup na, sidomos ai grupi jonë edhe tjerë kemi qenë dikush për gara të ndryshme në diciplina të sportit, dikush për mësim, dikush veç kemi qenë atje edhe atje i kemi marrë do vende t'mira, si me thonë të suksesshme në ato gara. Ka qenë edhe pse në elektroteknikë për shembull ka qenë një edhe pse serbe ka qenë, por te na këtu ka qenë ajo. Ajo e fitoi vendin e parë, mandej në matematikë e ka nxonë një i joni Besniku Kastrati.

Mandej përpos neve edhe studentat që kanë studiu në Zagreb që jonë kanë shqiptarë edhe ata i kanë nxënë vendet e para. Ka qenë ky Agron Dida e di që ka qenë edhe ai ka nxënë vend t'mirë atëherë në gara edhe ka qenë njëfarë Abdullahu mbiemrin. Shumë të suksesshëm kemi qenë në atë kohë.

Anita Susuri: Domethonë qato vitet Fakultetin kur e keni kry a ju ka prit puna apo si ka qenë? Se zakonisht menjëherë...

Xhafer Nuli: Unë para se me shku në fakultet e kom kërkua bursën prej "Trepçës". Ma kanë dhonë, ma kanë nda bursën "Trepça". Sikur të mos e kisha bursën e ndame prej "Trepçës" nuk kisha mujt me shku me studiu, nuk kisha mujt me studiu. Unë e di vet me të thonë të drejtën, osht' keq me thonë gjithë javën bukën me kos kom hangër, me ka një jogurt edhe qashtu deri sa e kom marrë bursën. Masi e kom marrë bursën nuk kom pasë probleme. Para se me marrë bursën, para se me marrë bursën se bursa m'u ka nda, por nuk m'u është aktivizu, nuk m'u ka dhonë menjëherë, bursa ma vonë ka fillu me rrjedh e qashtu qysh osht' dashtë. Dikur ma vonë kom pasë mundësi e kom marrë edhe një kredi të studentëve edhe i kom pasë kushtet bajagi mirë, kurrëfarë problemi nuk kom pasë.

Anita Susuri: Domethonë, atëherë u konë sistem që nëse një domethonë organizatë ose ta jep bursën pret që ti me shku me punu?

Xhafer Nuli: Pret që ti me shku me punu edhe gjithsesi nuk guxon me shku dikund tjetër pa ta dhonë pëlqimin ata. Pa ta dhonë pëlqimin ata nuk mundesh me shku dikun tjetër, s'mundesh me shku dikun tjetër se ta kanë dhonë bursën, t'kanë bursu për qata edhe unë e kom marrë bursën. Por sa e kom kry fakultetin jom lajmruë në "Trepçë", edhe "Trepça" menjëherë m'kanë ofru punë edhe unë jom punësue.

Anita Susuri: Në njëfarë mënyre e keni vazhdu traditën se edhe baba juj ka punu aty. A jeni nisë prej qasaj a pse?

Xhafer Nuli: Paj me të thonë të drejtën e vetmja mundësi, i vetmi vend që ta jep bursën në atë kohë ka qenë që kom mujt me marrë bursë ka qenë "Trepça", unë s'kom pasë tjetër. Në "Trepçë" kom konkuru se në "Trepçë", Stantërgu m'ka nda se një kohë i kanë nda. Jonë kanë repartet e ndame dikujt rafineria, dikujt Staritërgu, dikujt kjo Industria Kimike ku ta di unë. Mirëpo, unë në Stantërg jom konë, qaty kom shku.

Anita Susuri: Edhe ku keni fillu në Stantërg? Aty keni fillu tani në Mitrovicë me jetu a qysh?

Xhafer Nuli: Unë kom fillu në Stantërg me punue me 7 shkurt 1974 edhe mandej kom jetue tri vjet deri në '77-tën kom jetue në Zasellë në fshat. Mandej kom ardhë kom jetu në Mitrovicë. Gjithnji, gjithnji deri në atë kohë kemi qenë në fakt bashkësi familjare me vllaun e me nanën e krejt bashkësi familjare në banesë këtu, mandej në Mitrovicë kemi banue.

Anita Susuri: Fillimisht kur keni shku në "Trepçë: me punu, në Stantërg a e keni ditë punën ma herë si është?

Xhafer Nuli: Unë e kom ditë, e kom ditë se kanë punu edhe përpos, pothuajse nuk ka pasë familje në fshat tonë që s'e ka pasë dikond të punësum në "Trepçë", krysisht në Stantërg kanë qenë se qasaj pjese i ka taku ma shumë. E kom ditë, i kom ditë kushtet, s'i kom ditë detajisht mirëpo e kom ditë qysh i kanë tregue kushtet edhe rrethanat. E kom ditë që jonë kanë shumë të fshtira, e kom ditë që jonë kushtet që dojnë një përkushtim të veçantë edhe puna e don një përkushtim të veçantë. Puna në miniera osht' sikur puna në ushtri. Aty nuk ka me shku me lonë hajt me një indulencë të punës, mirëpo puna don përkushtim.

Aty kom hasë në mirëkuptim drejtpërsëdrejti se atëherë, tek atherë ka fillu pak ma shumë me ardhë kuadrat shqiptare. Unë një epror temin si drejtor, si drejtues që e kom pasë e kom pasë shqiptarë Shyqyri Kelmendin e kom pasë aty kur kom shkue. Në në vërtetë kur kom shkue jom lajmru ma s'pari të një Bahredin Osmani, ai ka qenë, mirëpo Bahredini mandej ka kalu tjetërkund edhe te Shyqyriu kom pasë një trajtim korrekt, shoqërorë. Ashtu që, në fund të fundit edhe një mocanik i imi ka qenë, se unë dy vjet kom mbet ma mrapa, ai dy vjet ka shku ma përpara meje aty.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Ju a keni punu në zgafellë brenda apo si ka qenë puna e juj aty?

Xhafer Nuli: Në Stantërg apo...?

Anita Susuri: Në Stantërg në fillim kur keni hy.

Xhafer Nuli: Puna ime ma s'pari si inxhinier, unë kom fillue në resorin e mirëmbajtjes të minierës. Ajo resor e ka një numër të madh të punëtorëve elektrikista, statorë, ndërtimtarë e ku ta di unë. Unë kom punu si shef i përgaditjes teknike të elektrikës një herë në fillim, mandej... Mirëpo gjithsesi gjashtë muaj kom qenë praktikant edhe s'ka pasë ndryshe, stazën e praktikantit osht' dashtë me krye gjithsesi. Me shkue si praktikant veç ki me shkue edhe me përcjell gjendjen, me përshkru gjendjen, me studiu gjendjen edhe në njëfarë mënyre me u njoftu me t'gjitha rrethanat, posaqërisht duhet m'u njoftu me rrethanat, me kushtet e mbrojtjes në punë. E mbrojtja në punë është një segment ma i randësishmi, segmenti ma i randësishmi tek minierat, në çdokund, çdo ndërmarrje, mirëpo tek minierat don një përkushtim të veçantë.

Mandej jom bo si drejtues ose shef i shërbimit elektrik, mirëpo në minierë po, në minierë osht' dashtë me shkue jo çdo ditë, mirëpo herë pas here. Aty osht' trajtu si vend pune që duhet me shku edhe në minierë.

Anita Susuri: Ju kur keni fillu në '74-tën atëherë u bo edhe Kushtetuta ka qenë si një... koha ma e mirë po mendoj.

Xhafer Nuli: Po.

Anita Susuri: Njëkohësisht edhe ka ekzistuar gjithmonë ajo që “Trepça” gjithmonë po punon për dikund tjetër, jo për zhvillimin e vendit tonë. Qysh osht’ mendimi juj për qito? Qysh e keni pa ju?

Xhafer Nuli: Po me të thonë të drejtën “Trepça” deri sa kom shkue, kur kom shkue une veç atëherë kanë pasë fillue kuadrat. Në fund t’fundit, unë kur kom shkue n’qatë kohë në “Trepçë” i vetmi inxhinier i diplomum i elektoteknikës në “Trepçë” prej shqiptarëve kom qenë unë. Që thashë, për Shyqyriun, Shyqyriu ka qenë xehtarë edhe tjerë, mirëpo inxhinier i elektro-teknikës në “Trepçë”, në krejt kombinatin “Trepça” kom qenë i vetmi unë shqiptarë.

Sa i përket pritjes edhe respektit të punëtorëve osht’ për çdo lavdatë punëtorëve shqiptarë. Nuk ki mujt me hasë, menxi s’kanë prit me pa kuadra shqiptarë që po shkojnë. Ma vonë kanë fillu me t’madhe me ardhë kuadra shqiptare. Kur kom shku unë të gjitha, mos t’thom për tjera, mirëpo t’gjitha brigadirat, mjeshtrit kryesorë i kanë qitë si brigadira të brigadave të caktume të punëve. Të gjithë brigadirat kanë qenë serb, tek ma vonë dikur kanë fillu me ardh shqiptarë. Dalë ngadal ata tu u tërhjek për shkaqe pune, për shkaqe të caktume, ndoshta edhe nuk mujshin me durue që dikush tjetër me i komandu a me i kërkun punë prej tyne, disa e lshojshin shkojshin nëpër Serbi, disa shkojshin në pension apo shkojshin diku tjetër edhe qashtu. Dikur ma vonë u bonë krejt t’gjithë brigadirat shqiptarë edhe t’gjithë udhëheqsat ata shqiptarë.

Në atë kohë osht’ punu mjaftë në “Trepçë”, osht’ punu me përkushtim, osht’ punu me vullnet. Me të thonë të drejtën unë kom punu edhe mas luftës. S’e di ka na hupi ai vullnet për fat të keq! Osht’ për keqardhje, por na hupi ai entuziazëm.

Anita Susuri: Kur ka fillu ajo gjendja pak ma... edhe me pa që po shkon teposhtë, po bohet ma keq?

Xhafer Nuli: Deri, prej ‘74-tës po thom çdo herë shkonte ma mirë deri në ‘81-shin, ‘80-‘81. Masi u bonë demonstratat e ‘81-tës, veç edhe pse ne ishim shumë kuadra s’u jepshim, nuk u dorëzojshim kurrësesi, mirëpo u pajke ajo tendenca që veç kanë hy. Kujtoj një rast për shembull kur u dashke me i dënue demonstratat e ‘81-tës, u dashtë mi dënue. Vijshin prej Komiteteve, prej atje, “Krahinës”, përpara i thojshim, “edhe duhet me i dënue”.

Ka qenë njëfarë Millosh Vojakoviç ku osht’ ai edhe ai erdh tha, “Duhet me i dënu”. Aty u gjind njeni që dul një i joni tha, “Kur u lajmru njeri, kur i kanë dhonë njerit pushim”. Njerit që ka qenë në demonstrata i kanë dhonë pushim me pagesë e ai në burg, bajagi osht’ marrë për demonstrata n’burg.

Anita Susuri: Domethonë veç që ka pasë qatë ditë pushim ai e kanë tradhtu?

Xhafer Nuli: Tash duhet eprorin e tij, eprorin e tij. Unë u çova i thashë, “Ma kadale, duhet me spjegu, me skjaru. Nuk mundet ai me shfrytëzu pushim edhe nëse ja ki dhonë. Nuk mundet ai me shfrytëzu pushimin kur osht’ n’burg”. Ai u çu tha, “Jo, jo rri qaty”, ai Milloshi tha, “Ka m’u përgjegj ai që ia ka dhonë”. Nuk disha a ia kom dhonë unë atë pushim a jo (qesh). “Ka m’u përgjegj ai që ia ka dhonë pushimin n’koftë ai, edhe ai drejtori kryesor që ish i minierës”.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita susuri: E a keni marrë pjesë edhe ju në '81-tën në demonstrata?

Xhafer Nuli: Jo, jo. Me të thonë të drejtën prej Stantërgut nuk, qashtu e patën blloku Stantërgun që nuk ka pasë kurrëfarë, nuk ka pasë, veç disa individë që jonë konë këtu se nuk ka pasë në demonstrata. U patën konë nja tre vetë edhe që te tretë i kanë pasë deligrue, qysh me thonë dënue.

Anita Susuri: E dimë që jonë edhe dy marshe që jonë organizu prej minatorëve që kanë shku deri në Mitrovicë edhe i dyti ka qenë po m'doket deri në Prishtinë.

Xhafer Nuli: E këto jonë ma vonë, ma vonë mandej mas '81-tës tash veç fillunë dalë ngadale ata hap pas hapi, hap pas hapi. U pajke për çdo ditë që dojke thjeshtë me u shu ajo krejt çka u kriju me vite të tona, me shu edhe me kthy edhe një herë atë regjimin e dominimit total të serbëve deri sa fillun edhe me i bo ndrrimet e Kushtetutës. U bo Debati Kushtetues atëherë u organizue. Njëherë fillun me mitingje serbët, me mitingje duke sha e duke gjujt lloq, t'gjithë për me bo një dominim serbët. Jo veç në Kosovë, por kryesisht asetë kryesor ish në Kosovë gjithsesi, por edhe në Mal të Zi e në Kosovë e Vojvodinë e në t'gjitha anët në mënyrë që me bo atë Serbinë e Madhe qysh e planifikojke Millosheviq³ e atëherë fillun ato tubimet, e shpallën bajagi ata atë debatin Kushtetues në mënyrë që në njëfar mënyre me na shti frikën edhe mos me guxu kërkush me qpurdh, me ndrru Kushtetutën.

Në atë kohë m'kujtohet fare mirë diku në shtator apo tetor e kanë pru, ka ardhë [Burhan Kavaja](#), Azizi [Abrashi], ka qenë Burhani drejtor i minierës, Azizi ka qenë drejtor gjeneral, e kanë pru këtë Riza Smakën edhe Halit Muharremin, dy jurista me na spjegu çka osht' puna e kësaj ndryshimit të Kushtetutës. Ata veç që nuk na thanë, "Çunu sa nuk ju hangër dreqi". Me thonë të drejtën aty e murrëm një mesazh shumë të fortë qe duhet me bo çmos se...

Anita Susuri: Në cilin vit kjo? Para marsheve?

Xhafer Nuli: Po para demonstratave, para marshit, prara krejt kjo në '88, në mujin shtator të '88-tës. Atëherë na kemi fillu m'u pregaditë edhe me bisedu, thjeshtë me diskutue edhe me e kundërshtu me çdo kusht ndrrimin e Kushtetutës, jo degradimin e nivelit të Kosovës, jo degradim por avancim me kërkue. Me pasë avansim se jo degradim. "Dojmë m'u konë të barabartë me të gjithë popujt tjerë të Jugosllavisë sikur që janë serbët, kroatët, maqedonët, sllovenët e tjerë." Shpesh thuhet, "Minatorët e kanë mbrojt Kushtetutën".

Nuk e kanë mbrojtë Kushtetutën, por e kanë mbrojtë pozitën e shqiptarëve me qenë e barabartë. Kanë kërkue barazi të shqiptarëve me popujt tjerë në Jugosllavi. Qajo ka qenë esenca e krejt asaj edhe në ato tubime, në ato tubime gjithëherë kemi bisedu edhe njëheri në ato tubime e kemi lavdru pak a shumë

³ Slobodan Milošević (1941-2006), udhëheqësi Jugosllav ngritja e të cilit në pushtet filloi në 1987, kur në Lidhjen Komuniste të Plenumit të Jugosllavisë ai përqafoi kauzën e nacionalistëve serbë të Kosovës dhe menjëherë më pas u bë President i Serbisë dhe revokoi autonominë e Kosovës.

Titën⁴, jo për diçka tjetër se qashtu u murrëm vesh, vetëm e vetëm me ngrit pezëm mes kroatëve... vetëm të reagojnë. Serbët nuk mujnë ja bajnë lavdrimin e Titos, kanë me reagu. Gjithëherë e kemi përmend edhe Titon, “Tito na i ka dhonë qito të drejta, ju po doni me na i marrë edhe ato”.

Mandej ato kalun osht’ majt Marshi për Prishtinë, Marshi i Minatorëve me 17 nëntor 1988, marshi ka fillu prej miniere, prej Stantërgu. Atë ditë nuk kom shku në punë në mëngjes për arsye se kom pasë me çu një fëmijë te mjeku. M’ka thirrë në telefon një bashkëpunëtor i imi tha, “Eja se punëtorët po dojnë me shku për Prishtinë”. Kom shku jemi bashkangjitë. Me të thonë të drejtë, me t’thonë t’drejtën kur i kom pa dathun atë këpucën {prek këmbët} kama cullak i kish dal, nëntor ka qenë, borë ka qenë domethonë 17 nëntori. Ma parë patë ra borë, dika, dika borë edhe ftoft ishte.

Ashtu të dathun e të deshun me ato robe t’punës aty kur i kom pa s’ma ka marr mendja që dojnë me shku në Prishtinë n’kamë. “Moni bre djem se s’mundeni në Prishtinë n’kamë.” Pasha Zotin thashë, “Hajde t’bojmë diçka, t’bojmë se në Prishtinë”. U afru një punëtor, m’tha, tha, “Ti po na thu”, drejt me të thonë te disa kisha njëfarë ndikimi. Tha, “Po Burhani [Kavaja] po thotë shkoni”. “A po thotë?” “Po”. “Ecni, ecni!” Thashë. Nuk e disha unë situata qysh është deri në detale, mirëpo e pash që thojsha mos po mujmë këtu me u tubu se nuk mund shkojmë në kamë. Mirëpo, ata ndoshta ma tepër i nxitën disa vende që i kanë ndal, që i ndalën e tu u munu m’i kthye e ata qaq ma shumë u nxitën edhe deri dikun në mëngjes jemi nisë këtu, në mëngjes në shtatë e diçka, atje kemi mrrri ka ora tre.

M’kujtohet fare mirë kur kemi shku te Tyrbja e Sulltan Muratit atje, përtej tyrbes pak ma anej na kanë dalë te ai Gazimestani që thojnë atje na kanë dal policia, kordoni i policisë u konë në dy anët, qeshtu krejt rrugën e nxuni. Tash erdh puna mu ballafaqu punëtorët me polici. Unë do kolegëve i kom thonë, “Hajde ju dalim përpara punëtorëve se mos po i... Tash kur të shtyhet po i dalim përpara po i thojmë që ndaluni kadale”, mirëpo na tu u shty mrapa e tu e thy atë kordinin e policisë edhe kemi shkue. Mirëpo shpejt mandej kenë edhe disa shqiptarë, ka pasë policë e u thy kordoni. Nuk kanë reagu, nuk kanë bo dhunë. E kanë lshu kordonin për me ardhë drejt, drejt në holl të Sporteve [Pallati i Rinisë dhe Sportit] në Prishtinë. Aty kanë mbajtë fjalë disa punëtorë, disa...

Korab Krasniqi: Çka osht fol aty, a po të kujtohet?

Xhafer Nuli: Urno?

Korab Krasniqi: Çka kanë fol?

Xhafer Nuli: Osht’ fol në përgjithësi për këto degradimin, “Nuk lejojmë degradimin e pozitës të shqiptarëve, dojmë me qenë të barabartë me të gjithë popujt tjerë edhe s’ka ndrrime kushtetuese qysh po kërkon Serbia. Kurrë s’i lejojmë edhe s’kemi m’i lejue”, qito sene edhe jonë, “Pse serbëve ju lejue gjithë ato mitingje, neve po na kritikoni edhe po mundoheni me na pengu?” Qito sene.

⁴ Josip Broz (1892 - 1980), i njohur si Tito, ishte udhëheqës i Jugosllavisë komuniste. Ai kishte shërbyer në role të ndryshme nga 1943 deri në vdekjen e tij në 1980.

Korab Krasniqi: A e keni taku naj politikan?

Xhafer Nuli: Urno, po.

Korab Krasniqi: Kur keni mrrri në Prishtinë konë e keni taku?

Xhafer Nuli: Ka ardhë [Azem Vllasi](#), ka ardh Azem Vllasi aty edhe mos gabofsha edhe [Kaqusha \[Jashari\]](#) nuk e di a ka ardhë.

Anita Susuri: A ju kujtohen ata çka kanë folë?

Xhafer Nuli: A?

Anita Susuri: Çka kanë folë?

Xhafer Nuli: Ja s'më kujtohet, nuk m'kujtohet mirëpo e di që kanë qenë edhe ata.

Korab Krasniqi: Qysh u kthyt masanej?

Xhafer Nuli: Masanej jemi kthy, se autobusat na kanë ardhë përmas, n'kamë kena shkue mirëpo autobusat na kanë ardhë përmas. Mandej i kanë aranzhu autobusat për m'u kthy në atë anë anej. A unë për veti me do kolegë jemi konë me një kerr të, kanë ardhë edhe kërret e "Trepçës", me një kerr të "Trepçës".

Anita Susuri: Mendimi i juj, çka keni arritë atë ditë? A ka pasë naj sukses?

Xhafer Nuli: Ajo ka pasë shumë sukses se ai marsh mandej e hapi rrugën për marshe tri ditore, tri ditë ka pasë marshe të pandërpreme, tri ditë prej të gjitha anëve të Kosovës, t'gjitha prej Dragashi, prej Gjakove, prej të gjitha anëve të Kosovës kanë ardhë tri ditë e tri netë kurrë pa nda deri sa ma n'fund i shperndajtën me dhunë. Remzi Kolgeci dul tha, "Ik se na... ose shpërndanu ose shkum na marun te tonë". Ma n'fund u shpërnda ajo edhe... minatorët prapë kanë vazhdu, disa kanë shku, gjithëherë në tona tubimet gati që jonë bo në Prishtinë, mirëpo e kemi majt të nesërmen me 18-in e kemi mbajt edhe këtu në Holl të Sporteve në Mitrovicë edhe prapë një tubim si prej Stantërgut.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu tani? A ka pasë presione?

Xhafer Nuli: Mandej ka pasë presione. Mandej thirreshin, duhet t'gjithë ata organizatorë duhet me i shti në burg e ku ta di unë. Dalke ai Lazar Molsovi, "E kom listën", thojke, "të..."

Anita Susuri: Organizatorëve.

Xhafer Nuli: "Të organizatorëve. E kom të 92 vetë që jonë përgjegjës" e ku ta di unë edhe deri sa ma vonë u organizu greva. Para se m'u organizu greva. domethonë dijani, shumë mirë u diskutu për këtë

çashtje qysh ka m'u bo ajo. "Duhet me hi, me nejt në minierë edhe m'u nguju deri sa t'i realizojmë tonat nuk bon me dalë". Ajo ka qenë, nuk ka qenë spontane që thotë dikush-dikush, nuk ka qenë spontane.

Anita Susuri: Kryesia e ka organizu, a qysh u bo?

Xhafer Nuli: Me të thonë të drejtën ato e kanë organizue në bashkëpunime me disa disa individë, por në bashkëpunim edhe me drejtorat, po po le të thotë kush çka të dojë. Drejtorat janë konë, tonë jemi konë. Na në njëfarë mënyre e murrëm mesazhin ma herët që duhet me bo çmos edhe jom i bindun që po të mos ishin drejtorat... Kqyre punëtorët sado kudo mundet pak me i frikësu e me i desorientue dikush, mirëpo po të mos ishin ata mirë të lidhun me punëtorë nuk kish me qenë ajo grevë edhe s'kish me pasë qatë jehonë.

Korab Krasniqi: A ekziston ndonjë organizator kryesor? A ka naj person?

Xhafer Nuli: Unë të thashë organizator kryesor aty, ata a janë marrë vesh, a janë marrë vesh me dikon ma nalt a jo. Mirëpo, për te na, për neve kanë qenë Azizi, Burhani. Për neve kanë qenë ata me punëtorë bashkë, po me punëtorë bashkë. Jo vetun s'kishin mujtë me bo, mirëpo i kanë pasë një grup të punëtorëve, Avdi Ukën, Jetush Bajramin, Sefedin Istrefin, janë disa disa të tjerë që me emra që i di që ka qenë. Besa thashë edhe Ibushi [Ibush Januzi] ka qenë si drejtor, veç faktikisht ajo nuk ka qenë spontan, por e organizume, e organizume.

Anita Susuri: A mundeni tash me na spjegu qato ditë që jeni kom brenda krejt çka ju kujtohet?

Xhafer Nuli: Ato ditë unë si drejtor i mirëmbajtjes ma tepër kom pasë përkujdesje, u dashtë me u organizue që me u përkujdes rryma mos m'u nal, ventilatori mos m'u nal, se mos me pasë ventilim, mos me pasë ajër ata s'kishin mujt me nejt aty as një moment, ashensori mos m'u nal, ashensori me punu kështu pa kurrëfarë domethonë. Kështu paisjet, infrastrukturën e minierës me majt në gjendje të rregullt. M'kujtohet fort mirë, fort mirë menjëherë qatë ditë në ora një, me 20 shkurt.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Po në ora një?

Xhafer Nuli: Me 20 shkurt, në ora një, Ibush Jonuzi, drejtor teknik ka qenë i minierës në atë kohë, m'ka thirrë tha, "Xhafer, minatorët u nalën në minierë", tha, "nuk po dalin". Na e dijsim, "A u bo? Hajde përhajr t'koftë". U kry ajo punë edhe kemi shkue, nuk ka vonu fort shumë, një erë ka fry edhe një Plep osht' thye nër shkollë të Trepçës atje, osht' thye edhe i ka ra telave të rrymës. E ka bo një lidhje të shkurt. Drejtë me të thonë desh m'lanë mentë, do me ardhë puna, don me na u nalë rryma. Si moment m'kujtohet, moment shumë trishtues për mu ka qenë, mirëpo shumë shpejt e evitum atë problem edhe nuk ka pasë mo, nuk ka pasë probleme sa i përket furnizimit me rrymë edhe ventilimit e këtyne tjerave, atyne çka janë konë të nevojshme për minierë.

Kemi shkue, kemi fillue. Osht' e vërtetë, osht' e vërtetë që jonë shkue, jonë organizue gjoja se me ju thonë dilni, mirëpo nuk ju kemi thonë dilni kurrë, por veç kqyrni rune vetën, runu mos u dëmtoni, si me thonë shëndetin mos e dëmtoni sa t'mundeni. Ka pasë dikur qaq një vetmohim ka qenë i madh sa që njerëzit fillun u smujshin, se tonë kohën t'u nejt mrenda. Mandej çizmet mathun, unë vet e di çizmet dikur fillun kamët me m'u bo varë se tonë kohën, tetë ditë e tetë netë pa i dathë çizmet, këpucët, u bonë kamët varë.

Tash u dashtë në fillim, ata që ishin të smutë i çunë në Mitrovicë në spital, mirëpo në ndërkohë dikur si duket, si duket e organizume edhe ajo kish qenë, mirëpo erdh një shofer tha, tu qajt tha, "Nuk muj ju çoj atje, se shkova nuk ma nalën atë të smutën. Thanë, 'hajt shko banu', m'keqtrajtnë". Atëherë kemi fillu e kemi bo një ambulancë provizore atje nalt në Stantëg, ambulancë provizore. Për atë e kemi kërkue, na i ka pru Kryqi i Kuq i Kosovës, 300 shtretër edhe 600 batanie i kemi sistemue nëpër ato lokalet që kanë qenë, që i kemi pasë në disponim atje edhe një ekipë e tonë e mjekëve ka ardhë prej Prishtine në krye me atëherë ka qenë ministri i shëndetësisë Skender Boshnjaku.

M'kujtohet Skender Boshnjakun e kanë thirrë, e ka thirrë Skender Boshnjaku të Ministrisë të Serbisë, në të vërtetë ata e kanë thirrë Skenderin, "Çka osht' atje? A ka nevojë me pru mjek?" Nuk ishte puna me pru mjek, por me pru agentë me shpërnda grevën. Tha, "Mjek nuk m'vyjn, çona barna. Mjek kom boll nuk du". "Jo po t'bijmë", "Hiç as një mjek mos ma dërgoni", tha, "po çomni barna n'qoftë se keni barna". S'ka çu kërkush. Na ka ardhë një kamion barna prej Kryqit të Kuq slloven edhe ato t'u e pru dikun te Rashka e kanë malltretu. Kur ka ardhë ai ish konë ai...

Anita Susuri: Vozitësi?

Xhafer Nuli: Jo përfaqësuesi i Kryqit të Kuq, desh ish tranue, "Qysh m'kanë trajtue, sa keq m'kanë trajtue", ai slloveni. Mirëpo, nuk kanë mujt me ja nalë se ai i Sllovenisë, s'kanë guxu bash qashtu me asi. Barna na kanë pru prej Sllovenie një kamion.

Korab Krasniqi: E me ushqim qysh jeni furnizu?

Xhafer Nuli: E ushqim, ushqim mandej kanë fillu prej të gjitha anëve prej Kosovës sa kanë mujt me pru, sa kanë mujt me pru. M'kujtohet një këtu i Mitrovicës, njëfarë Musa Berani e patë pru lopën, lopën dikun 500-600 kilogram e lidhi për gilindera aty tha, "Qe këto prene edhe qitjauni xehtarëve le t'kenë ushqim". Edhe pse greva e qujshin "Grevë urie", por nuk ka qenë grevë urie se ju kemi çu ushqim, ju kemi çu ushqim.

Anita Susuri: Se unë e di që ditën e katërt po m'doket. Ditën e katërt ka fillu.

Xhafer Nuli: Qashtu dy-tri ditë nuk kanë hangër, mirëpo ma vonë tani kanë fillu me hangër, ju kemi çue, ju kemi bajt. Ka pasë edhe të tillë që kanë kqyrë me problematizu ato bajagi, "Jo, kjo grevë urie", mirëpo u shku mirë çdo gja.

Korab Krasniqi: Qysh u konë aty pa dalë jashtë? Çka keni bo?

Xhafer Nuli: Unë kom dalë, nuk kom nejt tonë kohën aty për arsye se të thashë që tregova me organizime. Mirëpo...

Korab Krasniqi: Qysh ka qenë atmosfera për me nejt?

Xhafer Nuli: Atmosfera ka qenë shumë sa herë kemi shku i kemi gjetë ata të tubum. Atmosfera mjaft e rondë. Kemi pasë raste, kemi pasë raste për shembull kur njerëzit qaq të dëshprum, qaq që, “Kom me shku me ra n’pusore m’u myt se muj, muj”. Tjetri, “Në qofse vdes”, thojke, “m’varrosni në filan punishte, m’lomi me dhe nuk du me dalë përjashtë”, tjetri anej, tjetri anej. Me të vërtetë i kapi një... trishtim ka qenë, trishtim ka qenë. Mirëpo, qyshdo qoftë ka qenë një krenari. Ka qenë një krenari se e ndijshin edhe ata një krenari që po bojnë diçka se po bojnë diçka, se ja u çojshim gazetata me i lexu, iu çojshim informata me ju tregu që jeni të përkrahun prej krejt botës e për ushqim qeshtu.

Për ushqim më kujtohet një rast kur do të Lipjanit erdhën, prunë shumë ndihma prunë, por ma së mrami edhe dy kepë tha {tregon me duar}, “Qito na i ka dhonë një plakë, tha, ‘S’kom tjetër çka me ju dhonë, qito dy kepë’ po don m’i dhonë, ka dashtë m’i dhonë ajo vet, me ja u pru dy kepë”. Mandej një familje burrë gru e di që i kanë pru dy lira të arit, “Po dojmë me i dhonë kontribut për grevista, për këta këtu me qenë”. Ka pasë...

Korab Krasniqi: Qysh kanë komunikuar minatorët me familjet e tyre? A ka pasë komunikim?

Xhafer Nuli: Nuk ka pasë, veç çka kanë ardhë, kanë ardh deri aty me pa, me ditë çka jonë, “Thuji mirë jom hajt shko te shpia”, “Qysh n’shpi?” “Hajt mos na pengoni, s’ka”.

Anita Susuri: Prej kujt ka pasë vizita? Kush ka ardhë?

Xhafer Nuli: Vizita prej t’gjithë, prej krejt Kosovës. Ka pasë mandej që thashë m’kujtohet edhe rasti si rast i veçantë kur ka ardhë për shembull Azem Vllasi, në të njëjtën kohë me ata të Sindikatës të Serbisë, mirëpo na u dashtë mi qite, Azemin me qitë në një zyrë atje, në një njenën zyre, “Nal një herë deri sa t’shkojnë ata”, që mos të takohen, s’osht’ me randësi a osht’ a s’osht’ edhe mandej shkoi edhe Azemi i ka pa. Mandej kanë qenë prej t’gjitha anëve t’gjithë kush, si me thonë s’ke ditë kush osht’ ma...

Korab Krasniqi: Njo prej kërkesave u konë me i...?

Xhafer Nuli: Kërkesat, kërkesat t’gjitha kanë qenë nontë kërkesa kanë qenë të minatorëve. Njëna prej tyre ka qenë, “Kombet e Bashkume, Jugosllavia nuk osht’ në gjendje me zgjedh problemin tonë, dojmë Kombet e Bashkume m’u marrë me çështjen tonë”.

Anita Susuri: Me intervenu.

Xhafer Nuli: Me intervenu edhe me caktu, me caktu statusin tonë ku jemi na, jemi të keqtrajtum.

Korab Krasniqi: Kond keni kërku me dhonë dorëheqje edhe pse?

Xhafer Nuli: Edhe ka qenë, një nga kërkesat ka qenë tri dorëheqje. Me dhonë dorëheqje Rrahman Morina, Hysamedin Azemi edhe Ali Shukriu.

Korab Krasniqi: Pse?

Xhafer Nuli: Se ata që të tretë janë vu në si me thonë në anën e Serbisë, Millosheviqit edhe e kanë përkrah me çdo kusht me u bo ndrimi i Kushtetutës, me degradu çdo gjo që ka qenë shqiptare. Jonë bashkangjite aty e di edhe kur ka qenë Rrahman Morina nalt. Rrahmani ka qenë nalt, erdh tha, “Shko thunju, ‘Nxerrini punëtorët prej minire”, Azizit e kryne. Tha, “Rrahman, punëtorët jonë t’u e kërku dorëheqjen tonde. Jep dorëheqje e mos i merr n’qafë gjithë këta njerëz. Mos i le me...” Tha, “Jo s’muj, nuk guxoj me dhonë dorëheqje, nuk muj”. Qashtu bash m’kujtohet fort mirë.

Korab Krasniqi: A ka lyp me ju bashkangjit Rrahmani juve a?

Xhafer Nuli: Jo, jo veç në drejtori nalt, nalt se jo me shku në minierë as s’kish guxu, as s’e kishin pranue.

Anita Susuri: Kush ka qenë që ka shku poshtë në minierë prej udhëheqsëve për shembull?

Xhafer Nuli: Prej udhëheqsëve kanë shku thashë, kanë shku, kanë qenë Syria Popovci. Syriaja nuk ka dhonë kontribut t’vetin qysh duhet. Me të thonë të drejtën e kemi çmu shumë si profesor, por nuk e di pse u mundu me i arsyetu ndryshimet kushtetuese. Na veç e dijsim ma përpara çka paraqesin ato. Kanë qenë edhe disa të tjerë po s’po më kujtohet. Thash ky Azemi, mo Azemi ka qenë jashtë se mo nuk ishte në organe, nuk ishte në pushtet se ma parë e patën largue.

Korab Krasniqi: E Stipe Shuvari⁵ a ju ka vizitu?

Xhafer Nuli: Urdhno?

Korab Krasniqi: Stipe Shuvari?

Xhafer Nuli: Stipe, e mandej kanë ardhë prej Jugosllavisë. Ka ardhë Stipe Shuvari, ka ardhë njëfarë Radisha Gaqiqi [Radiša Gačić] edhe njëfarë Jurij Bajec kanë ardhë. Jonë mundu me i bind minatorët me dalë. Mirëpo, minatorët i kanë dhonë përgjegjje shumë të kjartë edhe shumë asi... Bile m’kujtohet fort mirë kur dul Stipe Shuvari tha, “Çka osht’ qaj?” Për një Mursel Hazirin. Mursel Haziri ka qenë grevist edhe ai edhe ka qenë i burgosun me këta grevistat ma vonë. Murseli tha, “Kush po i bon mitingjet në Vojvodinë?” Tha, “Po thojnë populli. Kush po i bon mitingjet në Mal të Zi? Po thojnë populli”, tha, “A na çka jemi?” Ky meti s’diti çka m’i thonë. “Pse për neve s’bon e për ata bon?” E kur dul tha, “Ky, çka osht’

⁵ Stipe Šušvar (1936-2004) ishte një politikan dhe sociolog kroat i cili konsiderohej të ketë qenë një nga politikanët më me ndikim komunist në Lidhjen e Komunistëve të Kroacisë në Republikën Socialiste të Kroacisë gjatë Jugosllavisë dhe më vonë në Kroacinë moderne.

qaj, filani”, tha. “Xehtarë”, tha. Tha, “Dom osht’ që ai është aty. Ai u duhet m’u konë këtu me neve”, demek nuk osht’ ai për aty se (qesh).

Anita Susuri: I ditun.

Xhafer Nuli: “Se s’po na len me fol. Ai ish dashtë m’u konë këtu”, tha, “me neve bashkë”.

Korab Krasniqi: Ju e keni pasë si kërkesë me ju vizitu Stipe Shuvari edhe Millosheviqi. Pse keni dashtë m’i taku ata?

Xhafer Nuli: Ka qenë kërkesë, jo për diçka...

Korab Krasniqi: Me ju kallxu çka...

Xhafer Nuli: Veç me ju kallxu që kot e keni se mo me neve nuk keni, nuk keni me qenë mirë përderisa tentoni me degradue. Ata, ka ardhë edhe ky Dizdareviqi⁶. Dizdareviqi nuk ka ardhë në “Trepçë” ma vonë, por ka shku në Prishtinë. Në Prishtinë kanë shku një grup prej pesë vetëve kanë bisedu me të. Nuk ka pasë pushtet Dizdareviqi, kurrëfar ëpushteti s’e ka pasë veç u emnu qashtu edhe s’ka mujt me bo kurgjo. Ka qenë me të edhe njëfarë Graqanin⁷. Ai ka qenë ushtarak, ka qenë një ushtarak shumë, qysh me thonë i poshtë, i ulët. Ai mandej ka thonë, se bajagi, “Nxirrini punëtorët me dhonë dorëheqje”.

Kushti ka qenë për me dalë prej miniere duhet me dhonë dorëheqje ata e këto tjerat pika masanej m’u realizu masi të dalin prej miniere, a pa dhonë dorëheqje ata tre nuk kanë me dalë prej miniere. Graqanini thotë, tha, “E mirë na s’mujme me dhonë ashtu se çka me bo që nesër hijnë serbët në Leposaviq” edhe qashtu ndodhi. Domethonë, na e kemi pregaditë edhe tjetrin skenarë, tash kanë m’u çu edhe ata.

[Këtu ndërprehet intervista]

Mandej kur kanë ardhë, kur dulëm prej miniere Shuvari edhe ai, atëherë kërkojshin me organizu një konferencë jashtë në restorant, a dikun në mënyrë edhe ishin aty mjetet e informimit të Serbisë, në mënyrë që me bo një inskenim që minatorët i nxerrëm, dulën. Mirëpo, nuk ka shku kërkush, vetëm na udhëheqësit organizativ të punës, drejtorja e shefa e qata, nja tre-katër vetë edhe nuk edhe ai me Azizin aty, nuk mujti kurrfarë, kurrfarë efekti nuk patë aty. Domethonë, greva vazhdoi edhe ma tutje.

Ma vonë deri sa i kanë pru, kanë dhonë dorëheqje, i kanë pru dorëheqjet edhe atë i kanë thonë, “Jo i dojmë...” Veç nënshkrimin ia kanë dhonë që po jep dorëheqje. I kanë thonë, “Jo veç nënshkrimin, por shko e dojmë me myhyrë”, i thojke (qesh), me vule. “Me myhyrë, shkoni jepini në Komitet, s’paku Komiteti le te vërteton që qita njerëz kanë dhonë dorëheqje”. Ja kanë pru, e kanë vulos edhe e kanë

⁶ Raif Dizdarević (1926) është një politikan boshnjak që shërbeu si presidenti i parë boshnjak i Jugosllavisë. Dizdarević mori pjesë në rezistencën e armatosur si një Partizan Jugosllav gjatë Luftës së Dytë Botërore.

⁷ Petar Gračanin (1923-2004) ishte gjeneral në Ushtrinë Popullore Jugosllave.

pru dorëheqjen, mirëpo ajo ka qenë krejt mashtrim. Kurrëfarë dorëheqje mandej nuk u apliku, mandej veç kanë fillu represalet. Masandej, mas greve edhe tonë ata punëtorë, një nga një ngadalë me i përsekutu, me i... kush ka qenë ma i zoshëm, kush ka qenë ma aktiv, çdo njenin e kanë... ashtu që këto janë disa detale që i maj n'mend.

Korab Krasniqi: E kom një pyetje edhe mo e ndali. Masi që keni m'ri artikulu kërkesat e juj politike nëpërmjet grevës edhe nëpërmjet marshit, qikjo bllokada tetë ditore në "Trepçë" çfarë pasoja ekonomike ka pasë në Jugosllavi?

Xhafer Nuli: Bllokadë tetë ditore nuk ka pasë najfarë pasoje ku me ditë çka, mirëpo aty, jo veç ajo bllokadë. Në "Trepçë" prej asaj periudhe mo punë nuk ka pasë qysh duhet se u prish, osht' marrë një iniciativë, osht' marrë një iniciativë që kështu në këtë formë nuk lejojmë, prej neve fitim kërkush edhe nuk ka mujt me pasë fitim. Ma përpara ka mujt me pasë efekte shumë të mdhaja "Trepça". "Trepça" për veti ka qenë gjigant ekonomik që ka majt, bile-bile numërohet një ndër industritë e para në ish-Jugosllavi.

Mirëpo, masanej nuk ka pasë punë qysh duhet. Çdo herë mandej mas grevës tetë ditore për çdo muaj, se ata kanë fillu përsekutimet diku 14 tonët edhe Lazër Krasniqin edhe këtë... 14 t'gjithë udhëheqësat minatorë edhe Lazër Krasniqi edhe Azem Vllasi që kanë qenë bashkë me ta. Ata i shtinë në burg. Tjerët dikund njëqind janë konë që janë ndjek për vepër penale edhe ata si aktivë në atë grevë edhe ata i kanë shti në burg deri ka tre mujë ditë i kanë majt. Kursë këta i kanë akuzu për vepër penale kundë-rrevolucion me vite të tonë me qenë të dënum.

Nuk i kanë marrë t'gjithë përmenihërë. M'kujtohet fort mirë njëfarë Veli Osmani, ka qenë një Veli Osmani një nga aktivistat ma të zëshëm të grevës aty. Ai thojke, "Kur m'kanë marrë m'kanë shti në burg sikur m'u bo dynjeja e jemja". Ditën e marrshin e lshojshin në shpi me shkue, natër e marrshin edhe e majshin gjithë natën tu e torturue e ditën e lejshin me shkue. Nga ana tjetër propaganda përhapje, "Veli Osmani i tradhëtoi shokët". Kemi pasë shumë kokëçamje, shumë probleme. Me ju thonë, "Osht' dashtë me organizu. Mosni, mosni propaganda osht' t'u e pru në të gjitha anës, mos e lejojmë".

Anita Susuri: Qajo ditë kur ka përfundu greva kur i keni pa minatorët domethonë, në çfarë gjendje janë konë? Çka keni pa qatë ditë?

Xhafer Nuli: Ajo ka qenë një gjendje shumë e rondë, se t'gjithë... këtu ka pasë ardhë një mjek i Kroacisë, një Slobodan Llang. Ai ka qenë përkrahës edhe ka ardhë prej Kroacisë. Atë ditë ka qenë pjesëmarrës kur u bo dalja e minatorëve. Bile, ai e ka pasë dhonë idenë që me dalë natën në dy ora, me 28 shkurt në dy ora të natës kanë dalë minatorët, u kry dalja. Që mos me dalë prej territ menjëherë në dritë se mundet me ardhë edhe deri te verbimi i syve, por ja u qitshin nga një fashë syve edhe ishte drita nejtse jo qaq e madhe, natë ishte ende. Ai e patë dhonë atë [rekomandimin] që me i majt pak një kohë që njerëzit me u klimatizu kadal-kadale m'u adaptue edhe mandej u kry ajo.

Mirëpo, ato ambullantat, ajo provizorja mbetë plot shtretër, plot me njerëz, por menjëherë fillun hynë policia, hynë agjentët edhe i tarashkatën, i kapën, i qitën. Mandej fillun ato ndjekjet e t'gjithëve me rend ka njo ka njo. Disa i kanë shti pak ma heret në burg, disa pak ma vonë, veç qata 14 i kanë shti përmnjëherë në burg. Mandej fillun edhe ndjekjet tjera për kundërvajtje, marrjet në pyetje t'gjithë me rend kush ka qenë aty pari, ashtu që...

Anita Susuri: Juve a ju kanë marrë në pyetje?

Xhafer Nuli: Mu m'kanë marrë n'pyetje. Kanë përdorë edhe taktika. Mu m'kanë marrë n'pyetje m'kanë thirrë, tha, "Eja në Tunel të Parë në hymje aty ku osht' porta". Prej Stantërgut në Tunel të Parë me ardhë goxha një rrugë, mirëpo ajo ishte edhe taktikë e tyne mas grevës. Taktikë e tyne që me t'pa njerëzit me kon po rrin, që je me ta edhe me thonë, "Kqyre ky". Kom thonë, "Jo, nuk vi!" Tha, "Çka?" Me telefon, "Ti po thu s'vjen?" Thashë, "Hajde burrë n'daq me ardhë jom këtu në zyre në 'Trepçë'. Hajde merrëm në zyre, ndaq çom në Sekretariat, ndaq qysh dush. Mirëpo nëpër rrugë, nëpër sokaqe nuk vi".

Ka ardhë vet i dyti me njenin, ai osht' njëfarë Golludi u konë i Zveqanit që m'thirri. Ka ardhë me një tjetër, njëfarë të Vojvodinës edhe mandej kanë fillu. Dorën në zemër edhe biseda edhe ajo intervista, ajo marrja n'pyetje në terren tem ma e lehtë ish, ma e lehtë ish se me shku nëpër llugave çka po di qysh. Aty në terren tem pak ma lehtë

Anita Susuri: Çka ju kanë pytë për shembull?

Xhafer Nuli: Po m'kanë pyet, "Kush, çfarë roli ki pasë ti në këto greva?" Thashë, "Na role s'kemi nda, film s'kemi luft. Unë e di rolin tem çka e kom t'punës, e kom rolin tem me i majt në gjendje të rregullt maqinat, ashensorin, ventilatorin, rrymën, pompat e ujit me nxerr ujin. Qito sene, ato detyrë e jemja s'ka kush që mundet me mi hjek, i kom të përshkrume në vendin e punës". "Po", tha, "I ke dalë, ju ke dalë kordorint të policisë përpara në Gazimestan atje edhe e ke shpernda kordonin e policisë". "Mirë", thashë, ky Gollubi m'ka njoftë {tregon me dorë} s'ja ka marrë menja. "Ti sigurisht s'më ki njoft. A ta merrke menja", se qaj m'vetke, "A ta merrke menja sa i zhvillum kom me qenë unë që e kom shty kordonin e policisë". "Jo", tha, "njeri kur osht' me masë osht' shumë i fortë", tha. "Ja", thashë, "lene ato përralla jonë. Hiqju atyne prrallave" e qito sene.

Mirëpo, e kom edhe një kështu (buzëqesh) detal me thonë. Gjatë asaj periudhe prej që i murrën këta në burg, tonë kohën e bajsha një bund të "Trepçës" se thojsh me më marrë bile pak a shumë mos me u konë ftoft se çka po din ti në burg e sene (qesh). M'kish pasë diktue një drejtor teknik u konë njëfarë Nexhati, m'kish pasë diktue, "Çka p'e banë qito?" Thashë, "Vallahi po don me të kallxu drejtë?" Tha, "Fol". Thashë, "Ma merr menja veç po pres kur ma ngjesin mas qafe edhe me shku bile nxet me konë" {prek setrën}.

Anita Susuri: M'u konë i përgaditun.

Xhafer Nuli: "Edhe kur të m'rrehin ndoshta s'ma deshin qito m'bijnë pak ma lehtë qato sene".

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Ju thatë që prej grevës mo puna nuk ka vazhdu në normalitet.

Xhafer Nuli: Prej grevës mo për çdo muaj, për çdo muaj ka pasë greva e ka pasë ndalesa t'punës e ka pasë pengesa. Ka qenë me 13 mars jonë nguju tri ditë në restoran. Me 13 mars domethonë, a jo me 15 mars në të vërtetë për tri ditë deri me 18-tin. Ajo greva u kry me 28-tin, një javë e kanë pasë pushim, mandej e fillun prapë punën. Me 15 mars u ngujun në restaurant edhe tri ditë kanë nejt aty edhe aty i shpërndan. Mandej ka pasë greva tjera. Po vlen me përmend edhe grevën e tetorit që ka qenë prej 27 deri me 30 tetor. Aty 62 minatorë jonë nguju në horizontin e tetë edhe këta kanë qenë pa bukë e pa ujë, kanë nejtë për tonë kohën, në kushte shumë të ronda.

Korab Krasniqi: 60 minatorë.

Xhafer Nuli: 62 minatorë, 62 minatorë.

Korab Krasniqi: Në nivelin e?

Anita Susuri: Tetë.

Xhafer Nuli: Në nivelin e tetë, në horizontin e tetë ata jonë nguju aty.

Korab Krasniqi: Në tetor a?

Xhafer Nuli: Në tetor.

Anita Susuri: 27 tetor a ke?

Xhafer Nuli: 27 tetor '89-tës, '89-tës domethonë të qatij viti. Edhe mandej ata jonë shku i kanë nxirrë me dhunë t'u i rreh qysh thojnë, i kanë nxerrë me dhunë.

Anita Susuri: A i kanë burgos ata?

Xhafer Nuli: Dhjetë prej tyne, tonë i kanë burgos. Dhjetë prej tyne i kanë çu për vepër penale i kanë dënu menjëherë, i kanë çu ka tre mujë ditë burg, kurse të tjetër i kanë çu në kundërvajtje. Mandej pas qasaj, pas qasaj ka fillu një fushatë e përgjithshme kështu krejt punëtorët, 1,214 punëtorë na kanë akuzu për kundërvajtje, listën prej 1,214 vetëve për kundërvajtje për shkak të qasaj greve. 778 si me

thonë, na kanë qitë prej pune, na kanë qitë prej punë krejt prej një deri në katër mujë ditë, s'kemi mujt domethonë na kanë largu.

Anita Susuri: Suspendim?

Xhafer Nuli: 778 [persona] suspendim kemi pasë.

Anita Susuri: Pastaj në vitin '90-të u bo largimi.

Xhafer Nuli: E mandej kemi, kemi fillu prapë, na nuk jemi nal na, vazhdimisht nuk jemi ndal. Mandej në vitin '90-të minatorët prapë aktivitet gjithëherë, gjithëherë kërkesa e parë ka qenë "Lirona shokët prej burgu" edhe prapë kërkesat që i kemi pasë gjithë, qato kërkesa ata i grahshin punës vet. Mandej fillun protestat gjithpopullore nëpër Kosovë edhe nëpër kësi. Me 20 shkurt 1990, prapë në përvjetorin e grevës kanë ardhë minatorët prej "Trepçës" kanë ardhë në kamë deri te ura e Mitrovicës këtu për me shkue, për me ardhë me ju bashkangjitë turmës të studentave, turmës në protesta.

Aty nuk i kanë lonë me hy, ja u kanë pru autobusat, ja u kanë qitë do autobusë, kanë dashtë m'i qitë në autobusa e me i çu në stadion. Atëherë një plan shumë mizorë ka qenë i tyne me i çu në stadion edhe aty me i qitë gaz lotësjellës edhe me i ngulfatë thjeshtë njerëzinë. Mirëpo, studentat ju kanë thonë, i kanë alarmu, "Mos hypni". Në të vërtetë i kanë çu deri te stadioni u kanë thonë, "Ikni mos hini në stadion", se bajagi me fol diçka. Atëherë jonë bashkangjitë me studenta edhe qatë ditë osht' vra Selman Vojvoda te Ura e Gjakut.

Anita Susuri: Kush është ai?

Xhafer Nuli: Selman Vojvoda, një student që osht' vra në ato protesta që kanë qenë. Bile kur ka qenë ajo si me thonë vorrimi i tina kemi qenë diku 500 mijë vetë kanë qenë në vorrim të tijna.

Anita Susuri: Qaty në stadion a ke qenë edhe ti? A ke shku?

Xhafer Nuli: Nuk kom qenë, nuk kom qenë atë ditë. Unë aty s'kom qenë. Mandej shtatë ditë, shtatë ditë nuk kanë, nuk ka pasë punë se domethonë hiq nuk na kanë... Se unë ato ditë për stadion nuk kom qenë për arsye se nuk kom qenë në punë fare se neve na kanë largue 700 e sa thash, 778 na kanë largu ma përpara. Deri me 14 prill nuk kom mujt me shku në punë.

Anita Susuri: I suspendum ke qenë.

Xhafer Nuli: I suspendum kom qenë po. Mandej i kanë, i kanë marrë ata, si me thonë mas asaj shtatë ditë nuk kemi pasë punë, s'na kanë lonë me punue. Mas qasaj që na kanë lonë me punue kur kemi shku në ditën e parë me 28-in, atëherë i kom organizue edhe kom organizu me formu Sindikatën e Pavarur edhe atë ditë e kemi majt një mbledhje në restoran edhe e kemi shpallë, e kemi si me thonë konstituë Kryesinë edhe Sindikatën e Pavarur në mënyrë që me u lidh, me qenë ajo si lidhje n'mes grevës edhe Sindikatës.

Korab Krasniqi: Kush ka qenë drejtor i kësaj Sindikate?

Xhafer Nuli: Urno?

Korab Krasniqi: Drejtor i kësaj Sindikatës?

Xhafer Nuli: Kryetar i Sindikatës prej themelimit edhe e kom themelu edhe prej themelimit deri në vitin 2000, në qershor të vitit 2000 kom qenë unë.

Anita Susuri: Qajo dita kur ju kanë largu që s'i keni pranë ato kushtet. A e mbani në mend atë ditë çka ka ndodh?

Xhafer Nuli: Atë prej... {zgjat dorë}

Anita Susuri: Në vitin '90 kur i largun krejt prej punës.

Xhafer Nuli: Kur na kanë largu qata 787 në vitin '90 që thash 787 në tetor. Ato s'kemi... ato veç janë konë punëtorët në minierë dhe qata punëtorë që janë konë qata 62 i kanë nxerrë me dhunë. Neve kërkon, sa kanë nejt ata në minierë s'ka punu miniera se s'u kanë rendi. Veç i kanë qitë ata edhe neve mo s'na kanë lonë me shku n'punë. Veç na kanë thonë, "Ju jeni të suspendum edhe n'punë nuk bon me shkue.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë tani qato vite pa punë?

Xhafer Nuli: Po ato kanë qenë vite shumë të tmerrshme. E mandej kemi pasë shku, mbas asaj greve, mbasi që është formu Sindikata edhe deri në muajin qershor, kesi gusht, me 8 gusht kemi shku në punë. Me 8 gusht kur kemi shku e kanë pasë derën e mbyllun. Me të thonë të drejtën mu m'kanë lajmruë prej centralës prej telefonave m'lajmrun, "Vallahi e kanë rrethu krejt 'Trepçën' diçka po bohet krejt ushtri jonë çu po m'doket". Na kemi shku, kur kemi shku s'na kanë lonë me hy, thotë, "Tash mo nuk bon me hy".

Kemi tentu me hy n'vandin e punës tonë. Kemi shku tre ditë rresht me hy n'vandin e punës tonë. Ma së mrami na ka dalë policia edhe na kanë dalë të armatosun në front. Bile-bile e kanë shpallë aty që na po dojmë m'u çu në kryengritje ashtu që me na inskenu njëfarë, njëfarë... Mirëpo, na thanë, "Këtu s'dojmë me ju pa, nuk muni me ardhë". Majtëm tubim një Këshill i Punëtorëve që na bajagi na nuk hekim dorë prej pune, na jemi punëtorë, mirëpo nuk na kanë lonë mo me shku, nuk kemi mujt me shku. E kanë qitë një listë masanej ata, e kanë qitë ata një listë me thirrë dikon, në mënyrë që me shpërnda. Tonë kohën qëllimi i tyne ka qenë me na përça, jo po asnjëherë nuk kanë mujtë me përça.

Na menjëherë mandej, menjëherë kemi fillu, Sindikatën e kemi pasë, kemi fillu me bo aktivitete në mënyrë që me siguru mirëqenjen e punëtorëve me çfarëdo mënyre me ndihma. Edhe pse ish gadishmëria shumë e madhe e popullatës me ndihmu me ndihma të popullit. Edhe nga ana tjetër mos

me ndal aktivitetin, mirëpo ai aktivitet me vazhdue edhe ajo frymë si me thonë e kundërshtimit me qenë gjithë prezente. Këto kanë qenë dy drejtimet tona, dy orientimet tona themelore, të atij veprimi sindikal që e kemi pasë.

Na domethonë kur na largunë menjëherë të nesërmen ose të masnesërmen kemi marrë një ndihmë prej Gjakovës, nja 7000 kilogram miell. S'e di cila ndërmarrje, a "Agimi" a cila ka qenë, tybe nuk e di. Mandej, kanë fillu do ndihma me ardhë kadal-kadale. Ka qenë një, ka qenë një frikë e madhe, një si me thonë psihozë te njerëzit që çka do të bohet, do të vdesim uni. Mirëpo, ka qenë kështu një organizim i jashtëzakonshëm me ju tregu njerëzve që nuk ka, kërkush s'ka me vdek uni, kërkush s'ka me vujt për ushqim. Kemi me pasë vështirësi, mirëpo deri në realizimin e qëllimeve tona na nuk kemi m'u tërhjek prej këtyne synimeve tona.

Mandej kanë fillu aktivitetet e llojllojshme. Para se me, harrova me thonë ato, para se me na qitë prej pune na kemi pasë, ka qenë pjesëmarrja, kontributi jonë në Kongresin e Sindikatës në Gjakovë që është majt me 30 qershor edhe 1 korrik, 30 qershor edhe 1 korrik u majt në Gjakovë. Aty kemi pasë edhe dekorimin [shpërndarja e dekoratave] me kristale me sene e kemi bo edhe kontributi i minatorëve ka qenë i jashtëzakonshëm, por edhe përkrahja e të gjithë atij Kongresi ka qenë për minatorë i jashtëzakonshëm.

Anita Susuri: Në cilin vitë ka qenë ajo?

Xhafer Nuli: Urno?

Anita Susuri: Cili vit?

Xhafer Nuli: '90-tës.

Anita Susuri: '90-tën.

Xhafer Nuli: Po, po në '90-tën. Na e majtëm atje në Gjakovë Kongresin e Sindikatës. Me 2 korrik u mbajt te Parlamenti që e majtën këta Deklaratën Kushtetuese.

Anita Susuri: Po, nënshkrimi. Çka ka qenë tjetër...

Xhafer Nuli: E...

Anita Susuri: Po, vazhdo.

Xhafer Nuli: Na ndoshta osht' pak... Iniciativën edhe kërkesën për me formu BSPK-në [Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës] se Sindikata e Minatorëve është sindikata e parë që osht' formu ndoshta në Kosovë, por ndoshta edhe në Jugosllavi. Sindikatë e Pavarur është kjo sindikata e parë. Si

me thonë, iniciativën për me formu BSPK-në na e kemi dhonë. Kemi shku te Hajrullahi⁸ [Gorani], kemi bisedu, jemi marrë vesh, e kemi bo organizimin edhe osht' kriju deri sa u majt Kongresi mandej edhe e kemi vazhdu kështu punën.

Mandej që thashë, me 8 gusht na qitën prej pune. Mandej ka vepru Sindikata, ka veprue LDK-ja [Lidhja Demokratike e Kosovës], kanë vepru jo partitë, ma shumë populli, ma shumë populli kështu. Osht' për mu përmend edhe për çdo lavdatë, osht' ndihma që na kanë ofrue vreshtarët e Malishevës menjëherë ato ditë me shkue. 460 punëtorë tonë i kanë punësu, prej një deri në katër mujë ditë kanë punu aty edhe kanë marrë t'ardhuna prej aty. Përpos asaj që kanë punue jonë organizu ajo pjesë e tyne, jonë organizue edhe krejt i kanë sistemu nëpër familje. Bile-bile ka pasë mes tyne, "Jo unë p'e marrë, jo unë p'e marrë minatorin, jo unë po du kaq minatorë". I kanë majt nëpër familje, deri sa kanë punu aty ata kanë nejt në familje të tyne aty, me ushqim me t'gjitha i kanë sistemu aty.

Vlen me përmend një nga ata aktivistë të asaj kohe ka qenë [Mulla Xhevati](#) i Bubavecit, osht' Mulla Xhevat Kryeziu edhe sot osht' asi [aktiv]. Ka qenë njëfarë, kanë qenë shumë por pak majnë n'mend. Ka qenë njëfar Bejtë Kryeziu edhe ai ka qenë se krejt nëpër të gjithë ato fshatra me Bubavec, me këtë tjetrin qysh po thirret me shku deri në hymje të Malishevës, me Bojë e t'gjithë ato fshatra i kanë marr me i pasë sa ma afër me punu në vreshtari.

Korab Krasniqi: Dashta me të pytë për këtë veprimtarinë e...

Xhafer Nuli: Problem shumë i madh, problem goxha shumë të madh kemi pasë edhe frikë të madhe kemi pasë kur ka ardhë puna me ja u bo pagesen me ja u dhonë të ardhurat, për arsye se ata masi patën dalë prej atje [punës në vreshtari] u duht me ja dhonë të ardhurat me ja u pagu. Kemi pasë problem për arsye se u duhke me shku me i marrë paret, e jemi organizu kush guxon me i marrë ato pare e me të nxon ku t'jetë ftyra? Ku jetë njeri? Kush mundet t'mbronë mo ty që gjithë atë mund e kanë bo njerëzia ma së mrami me ja u çu paret poshtë me shku huq. Mirëpo, kemi shku në mënyrë të organizume me të thonë të drejtën. Gjatë tonë kohës, gjatë dhetë viteve sa kom punu në Sindikatë jashtë "Trepçës", ilegalitet hesapi ka qenë ajo thujse, thjeshtë çdo herë të ndjekun kemi qenë. Gjatë tonë kohës asnjëherë nuk kom një rast që me thonë, "Qitu, qitu um dështoj" ose "Qitu m'lajmroj dikush prej bashkëpunëtorëve".

Kom pasë, kemi pasë një kompaktësi të jashtëzakonshme, një harmonizim, një harmoni të jashtëzakonshme. I falenderoj të gjithë ata që kanë qenë bashkëpunëtorë edhe ata që kanë punu në atë drejtim për atë aktivitet edhe për atë gadishmëri të punës që e kanë pasë. Mandej i murrëm ato pare, jemi ardhë, ja u kemi nda në Shipol aty i kemi pru, na i ka pru me kerr të vreshtarisë njëfar Haliti u konë shofer. Vallahi me të thonë të drejtën boll jemi tutë se haj medet, sa i kanë nda paret. Ka qenë një ndihmë shumë e madhe. Ajo ja u dha një stimul fillestar që me mujt me kriju njëfarë baze për dimër sado kudo do sene, do zahire sa për me kalu dimrin disi.

⁸ Hajrullah Gorani (1931- 2020) veprimtar, profesor, sindikalist shqiptar dhe ish i burgosur politik nga Peja. Ai ka qenë kryetar i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, një nga organizimet e para sindikale në Kosovë në fund të vitit 1989 dhe në fillim të vitit 1990. Ai mbahet mend edhe si udhëheqës i grevës së madhe të punëtorëve kosovarë, që u mbajt më 3 shtator 1990. U nda nga jeta më 6 korrik 2020.

Mirëpo, nuk kanë nda mo posaqërisht vlenë me i përmend ndihma që na kanë ardhë prej Presheve, prej Bujanovci. Ajo ka qenë diçka e paimagjinueshme. Kurrë nuk jonë ndal kamionat sa kanë mujtë me pru drith edhe jo drith por miell, se drithin e kanë çu, e kena pasë mullinin në Zhunicë te Selatini, njëfarë Selatini prej Zhunice. E kemi çu drithin aty, e kanë çu ata na kemi shku veç e kemi marr millin me kamiona.

Anita Susuri: A deshte me shtu diçka? [I drejtohet Korab Krasniqit]

Korab Krasniqi: Po veç e tha, e konsideroi këtë veprimtarinë edhe angazhimin e vet në Sindikatë si një lloj ilegaliteti. Pyetja jem, a e adresoni këtë angazhim sikur përkrahje për shokët e juv minatorë apo e keni pa edhe si fushë-veprimtari politike? A jeni ndi najherë të persekutum për shkak të qitij aktiviteti.

Xhafer Nuli: Fushë veprimtari politike me të thonë të drejtën kurrë ambicje politike s'kom pasë. Unë edhe kur jom vendos, unë jom vendos aty, unë e kom pa të udhës, e kom pa të udhës që duhet me u angazhu. N'fund t'fundit njerëzia jonë vra, njerëzia jonë shkue, duhet me u angazhu definitivisht, me dhonë një kontribut sado që t'mundesh, sado t'vogël çdo njëni. Në qoftëse çdonjëni nuk e dhojmë një kontribut nuk kemi me pasë prosperitet, nuk mundemi me pasë fitore. Kjo ka qenë krejt për çashtje, për çashtje kombëtare. Na Sindikatë i kemi thonë, mirëpo ma së pakti me punë, nejse s'osht' pak me punë sindikale, jena marrë me kriju mirëqenjen e punëtorëve. Mirëpo, thashë, të tregova që ajo në dy drejtime edhe drejtimi tjetër ka qenë çashtjet kombëtare me i çu përpara me kundërshtime, thjeshtë me i kundërshtu.

[këtu ka ndërprerje të intervistës]

Xhafer Nuli: Miniera e Stantërgut para se me na largu prej pune i ka pasë 3,050 punëtorë, 3,050 punëtorë. Prej tyne 2,716 na kanë largu shqiptarë edhe do boshnjakë jonë konë aty, mirëpo 2,600 jonë mbet aty serb diku nga 350 a sa po i bjen, as 350 edhe nja gjashtë shqiptarë jonë mbet aty. Jonë kanë pasë metë njo gjashtë shqiptarë që s'kanë çu peshë me të thonë të drejtën i kemi pasë distancu por jo me kurrëfarë asi [qëllime të këqija]. Mandej, ata kanë fillue, kanë tentu me i thirrë ka pak - ka pak tu i përpunu edhe mandej me i detyru me punue, mirëpo nuk kemi shku, s'ka shku kërkush, absolutisht. Të thashë gjashtë vetë veç kanë shkue edhe ata mandej kanë marr 120 punëtorë prej Tuzllës. Prej Tuzllës masi që ka ndodhë në Tuzëll një eksplodim i metanit që osht' shumë indikative, që ato e kanë përgaditë atje me ja u mbyll atje punën, me i pru minatorët k'o [këndej] me punue. Atje jonë mytë disa natyrisht metani kur eksplodon nuk shkon qaq lehtë edhe i kanë pru 120 punëtorë prej atje i kanë pru këtu me punu edhe disa të Gornji Millanovcit prej Serbisë, mirëpo kryesisht prej atje.

Na kur kemi marrë vesh që kanë ardhë ata, kemi shku edhe kemi bisedu. I kemi pasë taku disa ka marrin ujë aty, kemi bisedu i kemi thonë, "Mos na i nxeni vendet e punës. Çka keni lyp që keni ardhë?" Mirëpo, ata sidoqoftë kanë vazhdu qashtu. E kemi marrë e kemi shkru një apel, unë e kom shkru atë apel. Ja kemi çu një apel në gjuhës serbo-kroate që mos na i nxeni vendet e punës, qikjo çka na ka gjetë neve shpejtë ka me ju gjetë edhe juve edhe qashtu qiso sene diçka. Ja u kemi çu në oborr të

fabrikës. Përmenihërë, atë ditë 42 vetë jonë ikë, e kanë lshu jonë dalë, jonë shku me ecë prej shpie, jonë shku prej shpie. Jonë dalë me i nal, s'kanë mujt me i nal.

Mu të nesërmen kanë ardhë policia edhe m'kanë marrë. Këta të të SUP-it m'kanë marrë edhe m'kanë çu në asi... Ma kanë ngrit një aktakuzë kundër, kësi penale për kundërshtim të ligjeve të Serbisë, neni 216 qashtu e qujnë. M'kanë shti m'kanë torturu natyrisht, m'kanë toruturu në ato objektet e SUP-it, mandej kom nejtë një muj ditë në paraburgim. Mas paraburgimit, mandej jom liru por domethonë me qatë aktakuzë veç prej paraburgimit m'kanë liru.

Anita Susuri: A kanë ushtru dhunë vazhdimisht për një muj?

Xhafer Nuli: Jo vazhdimisht, veç qatë ditë, veç qatë ditë. Mandej i kom angazhu avokatë edhe mo, në të vërtetë s'i kom angazhu unë, mirëpo ma kanë angazhu njonin në Sindikatë e njonin vëllau edhe nuk ka pasë, dhunë s'ka pasë. E atë ditë po, atë ditë ka pasë dhunë edhe sjellje shumë brutale shumë, që për çdo keqardhje, por s'ki çka bon. Unë me të thonë të drejtën jo vetëm aty, jo veç ato, por muj me thonë që nuk ka pasë, mos me thonë mujë shumë për ato dhjetë vite që një herë nuk m'kanë marrë me m'çu me m'përpunu në Sekretariat edhe dhunë kanë ushtru vazhdimisht, dhunë.

M'kanë ardhë në shpi gjoja se po m'kontollojnë, "Hajde se ki, me t'kontrollu a ki armë. Ti ki armë. Qiti armët". Fëmijët unë fletë i kom pasë, djalin e vogël menjëherë aty, "Hajde dalim", thashë, "Këtë fëmijë mos ma tremni se kur t'çohet prej gjumit ju sheh kështu..." Dulem në tjetrën dhomë, bisedum tha, "Po i lypim prej teje tri, dy armë, jo tri, një pushkë, një automat edhe një allti, një revole". Thashë, "Vallahi", (qesh) thashë, thashë, "veç i lypni për kot s'kom kërkund ku me i marrë". Tha, "Ma mirë qiti armët e mos na shti me i hi ka s'delët, se e din ti çka t'gjonë", thojshin. Thashë, "Ju grahini hesapit t'juj qysh t'doni".

M'kanë marrë m'kanë çu në Sekretariat m'kanë përpunu deri asi, mirëpo ma tepër qëllimi ka qenë me m'i, m'i kanë mbledhë krejt dokumentacionet e Sindikatës çka i kom pasë në shpi. Mirëpo, dokumentacionin na e kemi pasë në dy vende të ndamë, një vend e ka majt sekretari, një pjesë e kom majt edhe unë edhe një pjesë e ka majt arkatari. Ashtu që, mirëpo ata dokumentet e mia i kanë marrë, veç këto ka i maj n'mend se dokumente nuk, edhe ato çka m'kanë shpëtu mandej shpia mu ka djegë në luftë edhe mo sot e atë ditë në shpi s'kom mujt me u kthy se shtëpinë e kom {tregon me dorë} përtej, anej urës e kom, në atë anë lbrit.

Anita Susuri: Deshta edhe me ju pytë qato një muj në paraburgim qysh ka qenë? Çfarë kushte i keni pasë?

Xhafer Nuli: Ato një muj në paraburgim kanë qenë shumë, shumë të kqia me thonë të drejtën. Sa i përket atyne, 13 ditë kom qenë në vetmi, kështu (buzëqesh) veç vetëm s'disha as çka me bo. Mirëpo, masanej kam qenë në dhomë. Ata të dhomës kanë qenë shumë korrekt edhe shumë m'kanë respektue, kom pasë një respekt të veçantë prej tyne. Ata osht' e keqja që i kanë përzi, i kanë përzi edhe ata të... kryesisht nuk kanë pasë kriminela vrasës në dhomë, por kom pasë hajna, me hajna po.

Anita Susuri: A kanë qenë shqiptarë a serb?

Xhafer Nuli: Ka pasë një serb edhe do shqiptarë, tjerët shqiptarë.

Anita Susuri: E përmendët edhe luftën, deshta m'u ndërlihd aty. Ku keni qenë gjatë luftës?

Xhafer Nuli: Unë gjatë luftës kom qenë në fshat. Atë ditë para se me, veç u kuptu që po dojnë me bombardu NATO, don me ndërhy NATO e sene. Unë kom qenë në fshat, në të vërtetë kom qenë në shpi. Kom dashtë me largu një djali se erdh djali i mixhës prej fshatit me m'thonë me dalë jashtë anej, po vetë ku me lonë familjen, nanën e kisha, grunë edhe tjerët t'vegjël krejt. Djalin e kom pasë 18 vjeç, djalin e madh, tjerët t'vegjël krejt. I thash djalit, "Shko ti, veç ti", por ai nuk dashti pa mu. Atëherë të nesërmen nana edhe gruja, "Çu shko ti haku i djalit". Kom dalë tash unë me to. Jemi dalë, jemi shku te një dhondër në Tavnik {tegon me dorë}, tani prej aty kemi dalë atje nalt në Zasellë.

Kom pasë unë raste, kom pasë që m'kanë ofru kushëritë, se ma përpara kom pasë paralajmrimë që ruju se nuk o puna mirë. Kom shku nalt në Zasellë. Atje kemi nejt gjatë tonë kohës, mandej gjatë luftës kemi nejt atje. Prej atje e kemi përcjell gjendjen çka po bohet tek po bohet. Me të thonë të drejtën osht' për trishtim diçka me thonë që qiky djali, qiky djali 18 vjet para se me dalë, atëherë ishte hallakamë në t'gjitha anët po m'thotë, e kom pasë një revolë t'vogël aty n'shpi, në të vërtetë vllau e ka pasë aty e po m'thotë, tha, "Pse bre babë revole? Pse s'po na i merr do bombë?" Thashë, "Pse bre djalë?" Tha, "Do bombë që me bo diçka, bile ma mirë me mytë vetën se me na masakruë". Aq m'ka pasë trishtu ajo që mandej në fshat atje kemi nejt.

Ka pasë, aty s'kom pasë naj rast s'kom pasë. Kanë ardhë i kanë djeg shpiat ma vonë, mirëpo nuk kemi nejt, kemi ikë kur e kemi pa që po vijnë, kemi ikë edhe kanë ardhë i kanë djegë shpiat. Na kanë granatue me 3 prill, na kanë granatue të '99-tës në fshat aty, por për fat të familjes teme nuk ka, nuk është damtu kërkush. Një familje të kojshive e kanë vra një edhe i kanë plagosë nja dy a tre a katër. Mirëpo, ka zgjat një granatim me këto pragat goxha gjatë. Mandej mas...

Anita Susuri: E familja juj ka qenë në Mitrovicë, gruaja?

Xhafer Nuli: Jo, jo. E mandej menjëherë unë prej këtu kom shku, kemi shku për Zasellë, mandej të nesërmen m'ka ardhë nana, gruja e fëmija. Krejt m'kanë ardhë në Zasellë edhe ata edhe kemi nejt bashkë, jemi konë bashkë deri me 2 maj [1999], deri me 2 maj. Me 2 maj, familja kanë shkue për Shqipëri, unë jom kthy me dy djem kom metë, me dy djemtë edhe një nip kom metë prapë në Zasellë. Aty kemi nejtë gjatë tonë kohës. Një diçka që e kemi pasë kështu edhe djemve i kom thonë edhe vet, "Po t'vjen ma mirë le të vret, mos u dorëzo, ik largohu. Me luftu s'mujmë, s'kem" s'kishim me çka luftojmë me ta. "Mirëpo mos u dorëzo".

Korab Krasniqi: Kur jeni kthy në shpi mandej këtu?

Xhafer Nuli: Në shpi mo kurrë nuk kom mujt m'u kthy se shpia u djegë vet. Mas një muj dite... e mandej m'kanë tregu fqinjët, m'kanë tregu fqinjët që se unë e kom pasë banesën, një banesë ma

përpara, aty ka banu, e kom lshu motrën me banue. Mandej shpinë e kom maru me vllaun naltë te spitali, mbi spital. Atë adresën e kom pasë që banoj në banesë gjithëherë edhe gjithëherë ata, shpesh kom pasë kokëçamje me ta, “Jo, ku banon ti?” Kanë shku në banesë atë natë m’ka tregu, m’ka taku një mas lufte m’ka taku njeni tha, “Atë natë” tha “kanë ardhë” tha, “edhe m’kanë pytë” tha, “A je ti Xhaferi?” Një kojshi tha, “Po, Xhaferi. Veç m’kanë kap *auuu* {onomatope} shkallëve te poshtë. Një gru dul tha, ‘S’osht’ ky, ai tjetër’. M’lshun”, tha, “mi dhanë do shkelma përmas, veç m’lshun”.

Të nesërmen familja... e të nesërmen që kanë granatu NATO që ka ra, të nesërmen jonë dalë familja prej shpie, prej shpisë atje, mirëpo në mengjes herët. Gjysë ore masi kanë dalë familja prej shpisë fqinjët m’kanë tregu, “Pesë vetë me maska kanë ardhë” tha, “pa kurrëfarë paralajmrimi veç kanë hy, dyrë e dritare kanë thy edhe sa kanë mujt me shti n’shpi, mirëpo s’kanë gjetë kërkon”.

Anita Susuri: Ju tani keni jetu në këtë pjesën jugore?

Xhafer Nuli: Jo, jo veç qatë natë kom bujt këtu në Tavnik, masanej t’nesërmen kom dalë atje. Mas lufte mandej deri në gusht kom jetu në Zasellë se s’kom pasë ku shkoj. Banesën e kom pasë atje, por banesë e nxone.

Korab Krasniqi: Banesën edhe shpinë?

Xhafer Nuli: Banesën edhe shpinë.

Korab Krasniqi: Shpia, a u djeg?

Xhafer Nuli: Shpia u djeg.

Korab Krasniqi: Në banesë s’keni mujt m’u kthy?

Xhafer Nuli: Në banesë s’kom mujt mu kthy se edhe banesën përtej Ibrit anej.

Korab Krasniqi: Çka kanë ndodh me ato? A kanë mbet andej apo i kanë shitë?

Xhafer Nuli: M’kanë mbet anej vallahi edhe mas njëzet vite ia kanë dhonë një serbi, as nuk pagun qira as nuk lëshon kurgjo, as...

Korab Krasniqi: Kur jeni konë herën e fundit në veri me i vizitu këto shpia?

Xhafer Nuli: S’mundesh me i vizitue, se s’ki ku i viziton.

Anita Susuri: S’ki shku hiç mo?

Xhafer Nuli: A?

Anita Susuri: Mo kurrë?

Xhafer Nuli: S’ki ku i viziton, as Habitati, as kurgjo. Shkojnë po thotë, “Çka po mërzitesh, banesa jote”. “Po qysh banesa jeme njëzet vjet t’u e shfrytëzu tjetërkush”. E kom qitë, e kom paraqit në gjyq, e kom paraqit në Habitat, e kom paraqit hala kurgjo, absolutikisht kurgjo.

Korab Krasniqi: E në Zasellë, sa t’ka ra me nejt?

Xhafer Nuli: Në Zasellë qysh?

Korab Krasniqi: Masi u përfundu lufta s’keni mujt me u kthy në shpi, keni ndejt në Zasellë s’ke pasë ku me shku.

Xhafer Nuli: Kom ndejt në Zasellë.

Korab Krasniqi: S’ki mujt mo me shku. Sa kohë t’ka ra me nejt atje?

Xhafer Nuli: Deri në gusht kom nejt.

Korab Krasniqi: Deri në gusht.

Xhafer Nuli: Deri në gusht. Masanej në gusht kom ardhë që po thom qato, kom ardhë qitu në Mitrovicë, dalshim krejt qisaj ndërtese dalshin se kanë qenë do serb kanë qenë këtu. E panë që i rujti KFOR-i nja tre-katër muj sa i rujti. Ata fillun me dalë. Atëherë e kom gjetë njenin, thashë, “A po e ndrrojmë banesën?” Tha, “Ani”. Jom hi unë n’qitë banesë, kom shku e kom çu në banesë teme çelsin e kom pasë në banesë, e kom çu në banesë teme. Mirëpo, ai mandej e ka lyp e ka qit në Habitatat kërkesën për banesë t’vet, mu ja kanë lëshu t’vetit diku apo... Ai m’thojke, “M’kanë ardhë do boksera m’kanë qitë” edhe tash banesa m’ka metë atje nalt. Mirëpo letrat, dokumentat i kom, osht’ e jemja po s’ka, me shfrytëzu jo kurrë.

Anita Susuri: Domethonë, kur u krye lufta Mitrovica mbeti qashtu përgjysë e ndame.

Xhafer Nuli: Po.

Anita Susuri: Qysh, çka keni mendu ju n’qato momente çka ka me ndodhë ma tutje kur ka mbet ashtu?

Xhafer Nuli: Me të thonë të drejtën osht’ bo, se njeri lehtë flet, mirëpo osht’ bo gabim i madh se osht’ dashtë në mënyrë të organizume, por në mënyrë të organizume nuk t’lojshin me shku anej, nuk lojshin me shku anej në mënyrë të organizume. Kur shkojshe në Urë të Ibrit knej ka qenë roja e KFOR-it edhe thojke, “A po shkon anej a po shkon knej edhe veç ka njo ka njo, jo në mënyrë të organizume. Këtu mos na rri”. Se u tubojshin disa njerëz aty edhe qashtu.

Anita Susuri: A keni vazhdu tani? A keni shku në “Trepçë” mas përfundimit të luftës kur janë largu serbët?

Xhafer Nuli: Kqyre, na shpeshherë i kritikojmë të tjerët, mirëpo goxha shumë kritika kemi edhe për veti. Duhet me kritiku vetëveten, osht’ tragjedi, osht’ dëm i madh, është dëm i madh që menjëherë masi që jonë kthy, menjëherë masi që ka përfundu lufta ka hi KFOR-i këtu. KFOR-i ka hi me 19 në Mitrovicë, unë me 21. 19 u konë e shtune, unë 21 kom ardhë në Mitrovicë me djem kom ardhë edhe jom taku me do të KFOR-it qaty në hymje të Mitrovicës. M’kanë pyet, “Çka ka në këto fabrika? Çka jonë? Tek jonë?” E kishin, një përkthyes e kanë pasë serb por ushtar të veshun në ushtri, ushtar të KFOR-it francez e ai përkthejke në serbisht, në serbisht u marrshim vesh.

Thash, ma lypi emrin, mbiemrin. Thashë, “Masi ma morre emrin mbiemrin ma jep edhe ti”, oficerit, “edhe ti emrin mbiemrin”. Ma dha emrin mbiemrin. Thashë, “A muj me ardh?” Tha, “Mundesh me ardhë”. Kom qenë s’di sa herë në kazermë, kurr mo nuk m’kanë nal (qesh) me fol, se dojsa me shku në “Trepçë”. Kemi tentu me u organziu me shku në “Trepçë”. Me të thonë të drejtën i kom tubue qitu në Tavnik nja 10-15 vetë me shku s’paku veç me ndërmarrë mos me vërshu uji, mos me na marrë uji minierën se problemi ma i madh osht’ me marrë minierën uji aty. Mirëpo, ma n’fund erdhëm te konstatimi që duhet me shku me u marrë vesh me të UÇK-së. Po të UÇK-së që i takojnë atij regjioni kanë shku në Vushtrri. Kemi shku në Vushtrri na kanë thonë, “Ejani nesër”. Kur kemi shku nesër s’na ka ardhë kërkush.

Mandej u formun katër borde shqiptare {tregon me gishta}, “Na jemi legjitim, na jemi legjitim, na jemi legjitim” edhe prej qershorit, prej 22 qershorit deri me 22 dhjetor nuk kena mujt me shku ne “Trepçë” se tu u shty mes veti. Kur shkum na gati veç që s’e gjetëm të vërshume minierën. Për fat të mirë, për fat të mirë në momentin e fundit e kemi shpëtue edhe miniera sot e atë ditë është e shpëtume. Se valla orët kanë qenë, minutat kanë qenë në pytje, 30 centimetra ka qenë uji në stacionin e pompave, 30 centimetra uji i thellë ka qenë. Edhe njëzet a qashtu me pasë shku i kish marrë motorat edhe mo kfit je konë kurgjo s’ki mujt me bo, absolutikisht kurgjo s’kishe mujt me bo.

Mandej kemi pasë peripeti masi kemi shkue me 22 dhjetor kemi pasë goxha peripeti mes veti këtu t’u na shantazhu, “Çka po doni?” S’di çka, mirëpo na dojsim me shku në mënyrë qysh kemi qenë të organizum ma përpara qashtu me shku, jo me ato rrokada me borde t’reja me ku ta di unë. Këto kanë qenë, kjo është mjerim i joni, le t’thojmi çka t’dojmë kujtëdo që t’i thojmë.

[Këtu ndërprehet intervista]

Aty KFOR-i u konë, serbët kanë punue qysh jonë konë përpara deri sa jemi shku na. Me 22, me 22 mo nuk kanë ardhë shkijet [serbët], nuk kanë ardhë. Kur kemi shku e kemi gjetë gjendjen veç para kollapsit si të thush. Me të thonë të drejtën e kemi gjetë gjithçka trishtuese edhe vend të torturave që i kanë bo njerëzve të lidhun me litar në podrum të restoranit. Mirëpo, s’kanë ndërmarrë kurgjo. Ato u dashtë KFOR-i m’i kqyr. Kërkush absolutikisht, absolutikisht kërkush nuk ka marrë. Kemi gjetë, kemi gjetë drrasën ku ka torturue edhe stërpikët e gjakut deri në tavan.

Anita Susuri: Mirë zotri Xhafer nëse keni edhe diçka ju me shtu vetë nëse doni edhe diçka që keni harru.

Xhafer Nuli: Jo diçka të veçantë nuk kom, qito, qito kanë qenë. Mandej po thom për ma vonë “Trepçën” dy-tri herë i kemi pasë minutat n’pytje me vërshu uji, me marrë uji, por në momentin e fundit ja gjejsim zgjidhjen, ja kemi gjetë zgjidhjen. E di që po të thom ndoshta as çdo dy ditë nuk kanë kalue që m’u ka dashtë me shku natën.

Sa herë u ndal rryma këtu kanë qenë punëtorët serbë në Trafostacion. Ata në ndrrim të tretë nuk punojshin edhe tash u dashtë me thirrë njëfar Viktori u konë s’e di i UNMIK-ut u konë një përfaqësues, ai m’i thirrë ata edhe me ardhë me lëshu tensionin, mirëpo ka pasë raste që ata s’jonë ardhë jonë çu vet kom shku e kom lëshu rrymën se edhe qat profesion e kom. Jom shku ja kom thy derën, bile një herë një ksi oficer me mue aty qesi te Xhandarmërisë të UNMIK-ut, tha, “Kush p’i then dyert? P’e dijmë kush p’i thejka”. Thashë, “N’daq dije n’daq mos dije”. (qesh)

Anita Susuri: (qesh) Mirë zotri Xhafer, faleminderit shumë!

Xhafer Nuli: Me nderë kofsh!

Anita Susuri: Ishte knaqësi.

Korab Krasniqi: Faleminderit shumë!

Xhafer Nuli: Faleminderit edhe juve. Ndoshta ju shurdhova veç...

Anita Susuri: Jo, taman qashtu e kemi na.

Korab Krasniqi: Na ki knaq, jo me na shurdhu.